


Prof. Dr. Agron Fico është albanolog, gjuhëtar, studiues i etnokulturës, specialist i gjuhës shqipe për të huaj. Ka ngritur dy katedra të gjuhës shqipe jashtë Shqipërisë: në Pekin (1961-1965) dhe në Michigan (1996-2000). Ai ka përfaqësuar shkencën dhe kulturën shqiptare në një varg konferencash kombëtare dhe botërore.

AGRON FICO Si e nxita Kadarenë të shkruante romanin “Dosja H”?

Në qershor të vitit 1966 do të organizohej në Shqipëri simpoziumi i Shoqatës së Studimeve të Europës Juglindore, por problemi ishte se do të ftoheshin shkencëtarë nga BS dhe USA. Pas diskutimesh të nxehta midis Ministrisë së Jashtme dhe Akademisë së Shkencave, ishte udhëheqja e lartë e partisë që i hapi dritën jeshile hyrjes së profesorit amerikan dhe atij sovjetik në Shqipëri.



Portreti nga Ina Lajthia

(fq. 2)

NJË SHKRIM I PABOTUAR I SHUTERIQIT I VITIT 1998

Arsimi dhe kultura në qytetin e Voskopojës në shek. XVIII

nga DHIMITËR S. SHUTERIQI

(fq. 4)

MARRËDHËNIE MITIKE SHKRIMTAR- LEXUES

Çmitizimi i shkrimtarit

nga Mira Meksi

Në fillim të kohërave shkrimtari nuk ishte, vepra po, ishte aty, ndërsa ai jo; ekzistonte vepra e shkruar, ekzistonte lexuesi që e lexonte, porse shkrimtari nuk qe, ose më mirë, nuk qe i dukshëm, qe i padukshëm dhe, për pasojë, nuk kishte as marrëdhënie të drejtpërdrejta shkrimtar-lexues. Ç'do të thotë kjo?

(fq. 13)

“PENA ËSHTË MË E FORTË SE SHPATA”

Rreth romanit “Labirinti i shpirtave”
nga Carlos Ruiz Zafón

(fq. 7)

ME DHEMBJEN PËR VETEN NGARKUAR NË KURRIZ

Për dramën LETRAT bazuar mbi
tregimin e Ylljet ALIÇKËS

nga Arta MARKU

(fq. 6)

MUZEU “SOLOMON” SI TREGUES I HUMANIZMIT DHE ALTRUIZMIT TË QYTETARËVE TË BERATIT

nga Yzedin Hima

(fq. 12)



ISAAC BASHEVIS SINGER

Kush ka nevojë për letërsinë?



(fq. 14)

NATYRA NJERËZORE
tregime nga
Alida Frashëri (Bodini)



DRERË DHE
FIZARMONIKË
poezi nga
Rigel Rizaj



TAKIMI ME
VRASËSIN TIM
tregim nga
Biser Mehmeti



TE VARRI I DANTES
tregim nga
Ndue Dedaj

Prof. Dr. Agron Fico është albanolog, gjuhëtar, studiues i etnokulturës, specialist i gjuhës shqipe për të huaj. Ka ngritur dy katedra të gjuhës shqipe jashtë Shqipërisë: në Pekin (1961-1965) dhe në Michigan (1996-2000). Ai ka përfaqësuar shkencën dhe kulturën shqiptare në një varg konferencash kombëtare dhe botërore.

AGRON FICO

Si e nxita Kadarenë të shkruante romanin “Dosja H”?

Profesor Fico, ju keni shkruar një libër me titull “Zbulimi i eposit shqiptar në Harvard - Albert B. Lord”. Ju keni pasur njohje personale me profesorin e shquar të Harvardit. A mund të na thoni se si u njohet me të?

Në qershor të vitit 1966 do të organizohej në Shqipëri simpoziumi i Shoqatës së Studimeve të Europës Juglindore, por problemi ishte se do të ftoheshin shkencëtarë nga BS dhe USA. Pas diskutimesh të nxehta midis Ministrisë së Jashtme dhe Akademisë së Shkencave, ishte udhëheqja e lartë e partisë që i hapi dritën jeshile hyrjes së profesorit amerikan dhe atij sovjetik në Shqipëri. Në mëngjesin e datës 25 qershor erdhi delegati sovjetik dhe pasdite pritej të vinte nga Budapesti në Tiranë Prof. Albert B. Lord. Më caktuan të isha njëherazi shoqëruesi kryesor dhe përkthyesi i Lordit. Fatmirësisht më kishte rënë në dorë dhe kisha lexuar me kujdes dhe me shënime veprën themelore të Lordit *The Singer of Tales*, në të cilën ai vuri bazat e një teorie të re të strukturës dhe kompozimit të eposit epik popullor, si kyç për të kuptuar veprat klasike *Iliada* dhe *Odiseja* të Homerit. Në një letër të dytë profesor Lordi, i njohur si duket me situatën politike të Shqipërisë, si vend i izoluar dhe me një përgjim të egër ndaj vizitorëve të huaj, pyeste se a mund të sillte me vete edhe një magnetofon dhe aparat fotografik, që të regjistronte ngjarjen shkencore dhe shfaqjet folklorike. Kjo kërkesë më vuri në mendime dhe dëshmonte se si shihej Shqipëria nga bota demokratike. Profesor Lordi gjatë rrugës së kthimit për në Tiranë, më tregoi për ekspeditën në Shqipërinë e veriut më 1937, si edhe për regjistrimin e këngëve popullore shqiptare e vecanërisht të atyre heroike. Lordi shtoi se në Harvard kishte një fond të epikës heroike shqiptare dhe se mendonte që fondin shqiptar ta botonte në një vëllim të veçantë në të ardhme.

Kumtesa e Profesor Lordit rreth epikës legjendare dhe rolit të rapsodit në pasurimin e varianteve bazë, u ndoq me interes dhe ngjalli diskutime të shumta. Pas dy ditëve të ngjeshura me kumtesa dhe diskutime, pjesëmarrësit shkuan në Shkodër që të merrnin pjesë në shfaqjen e grupeve folklorike, që u mbajt në teatrin “Migjeni”. Prof. Lordi u largua drejt Italisë për të qëndruar disa ditë në Akademinë Amerikane në

Romë. Andej dërgoi një letër falenderimi për pritjen dhe mbarrëvajtjen e simpoziumit të zhvilluar në Tiranë. Letrën ma dhanë mua ta përktheja. Në përmbajtje, siç përmenda më lart, kishte mirënjohje dhe falenderim për rektorin Kahreman Ylli. Në letër profesori shtonte edhe këto fjalë:

“Falenderim i takon edhe studiuesit të ri Agron Fico, jo vetëm si përkthyes.” Letra e dërguar nga Lordi doli se ishte hapur paraprakisht nga Sigurimi i Shtetit, gjë që m'u bë e qartë kur më thirrën në Degën e Punëve të Brendshme të Tiranës, ku me klithma m'u kërkoi t'u shpjegoja kuptimin “jo vetëm si përkthyes” që përmbante letra. Këtu fillon edhe saga e pareshtur e vuajtjeve të mia që më ndoqi plot 17 vjet. Nga kërkimet në Universitetin e Harvardit në kapakun e fletore së parë, shkruar anglisht lexohej: “Koleksioni i baladave heroike dhe këngëve popullore të Shqipërisë, mbledhur nga Albert B. Lord, 1937”. Ato janë gjithsej 12 fletore me 1350 faqe. Fletorja e fundit, me numrin 12, përmban treguesin e 100 këngëve, që përfshihen në tetë fletoret e para. Pra, fletorja e treguesit të lëndës (ajo me numrin 12) nuk është e plotë, në të nuk përfshihen këngët e fletoreve, 9, 10, 11, të cilat sipas Lordit, janë dërguar më vonë nga Shqipëria; nga bashkëpunëtorët e tij Qamil Hoxha nga Bicaj (Kukës) dhe Murat Paci nga Tropoja. E gjithë lënda e mbledhur nga Lordi në Shqipërinë e veriut në vitet 1936-1937 përmban 114 tekste, të mbledhura nga 36 rapsodë të ndryshëm. Kjo dëshmon për një hulumtim të përpiktë dhe përzgjedhës, për kërkime cilësore. Profesor Lordi, edhe pse atëherë i ri në moshë, ka ndjekur një metodikë rigoroze pune në terren dhe ka kryer kërkime një hapësirë gjeografike tepër të gjerë, që përfshin krejt Shqipërinë e veriut. Regjistri i parë daton më 4 shtator 1937 dhe i fundit më 13 tetor 1937, pra një kërkim tepër i ngjeshur dhe intensiv. Ja edhe vendet e eksploruara: Shkodër, Kastrat, Bogë, Theth, Abat, Mërtur, Kolgecaj, Tropojë, Bytyc, Bicaj, Prizren, Dukagjin, Pukë. Çdo këngë e mbledhur është e pasaportizuar: vendi i mbledhjes, data e regjistrimit, përkatësia fetare e rapsodit, shkollimi dhe të dhëna të tjera. Këngët e mbledhura sipas gjinisë dhe llojit





i përkasin epikës heroike, pra vendin kryesor e zënë bëmat e Mujit dhe Halilit, por në regjistrimet në disqe alumini të rapsodëve dygjuhësh ka edhe mjaftë këngë lirike dhe historike shqiptare. Secila pllakë zgjaste 4+4minuta nga të dy anët. Këto incizime janë përdorur edhe nga muzikologu i njohur hungarez Bela Bartok, kur punonte për transkriptimin muzikor të tyre në Universitetin Columbia, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shkencëtarët e njohur amerikanë Milman Parry dhe Albert B. Lord të Universitetit të Harvardit krijuan teorinë gojore, për zbërthimin e enigmës disa shekulllore homerike, zbulimin e ligjit të ngjizjes dhe krijimit të poemave homerike, njohur dhe si Teoria gojore Parry-Lord. Lordit vetë i pëlqente ta quante studim të Letërsisë Gojore tradicionale. Me kërkimet në terren në Ballkan, në vitet 30 të shekullit të kaluar, mblodhën një lëndë folklorike të pasur dhe të larmishme të këtyre trevave, që u bënë laborator i kërkimeve të tyre; pra hodhën themelet e teorisë moderne të folkloristikës.

Profesor Fico, kam dëgjuar se ju e keni nxitur Kadarenë në krijimin e romanit “Dosja H”. Për kureshtjen e lexuesve, a mund të na flisni më konkretisht?

Duhet të ketë qenë nga fundi i viteve '70, kur Kadare kishte shkruar një ese të mrekullueshme për ciklin e kreshnikëve në revistën “Nëntori”. Për interesin e madh që kishte ngjallur kjo ese, ishte vendosur që ajo të përkthehej në gjuhë të tjera, madje edhe në serbokroatisht. Por nga Instituti i Kulturës Popullore disa njerëz, të ndikuar nga metoda sovjetike, e shikonin eposin si vepër e fshatarësisë kundër feudalëve, kur në fakt ishte lufta e popullit shqiptar kundër pushtuesit sllav. Këndoheshin 10 mijë vargje, si në kohën e Homerit, nga lahutarët shqiptarë e të tjerë bilingvistë.

Ato ditë e takoj Kadarenë fare rastësisht në sheshin “Skënderbej”. E përgëzova për esenë mbi eposin e kreshnikëve, ndërsa ai m'u përgjigj:

- Mirë ti po më lavdëron, por ata të Institutit [të Kulturës Popullore] po më gjuajnë me shkëmbinj dhe

nuk ndalen.”

- Nëse do ta zgjerosh temën e eposit të kreshnikëve do të sugjeroja veprën e prof. Lordit, -i thashë, bindur që do ta bëja kureshtar.

Teksa më dëgjonte, e ndieva se si u përfshi emocionalisht. Kishte padurim për ta patur librin sa më parë në dorë.


Dhe kështu u takuam rishtazi, ia dhashë librin e profesorit tamerikan ku flitej për përkatësinë e eposit të kreshnikëve.

Nuk do të kalonte shumë kohë, kur mësova se Kadare kishte shkruar një roman të ri Jam i lumtur sot kur mendoj se ai shkrimtar i madh e ktheu në vepër artistike të jashtëzakonshme këtë të vërtetë shkencore të profesor Lordit duke shkruar romanin “Dosja H”, aq të vlerësuar nga lexuesi dhe kritika.

Ndërkohë profesor, ju shkuat vetë në Amerikë dhe tashmë jetoni atje. A jeni takur me familjarë të Lordit, a i keni ruajtur marrëdhëniet me to?

Pasi kisha filluar mësimin e gjuhës shqipe me diplomatët amerikanë në ambasadën e tyre në Tiranë. Një nga diplomatët, zonja Jacqueline Muller u tregua e gatëshme që të rivendosja marrëdhëniet me familjarët e Lordit. Zonja Jacqueline Muller, pasi u kthye nga një vizitë pune në Amerikë, më tha, se ishte interesuar për fatin e Albert Lordit dhe kishte mësuar se ai kishte ndërruar jetë para disa viteve dhe se familja e tij banonte në shtetin e Massachusetts. Vajza ime e madhe Albana, e cila ishte në Amerikë, vendosi kontaktet me zonjën Lord nga ku unë u mirëprita në shtëpinë e saj për të kryer studime rreth punës së Albert B. Lord dhe Melman Parry në universitetin e Harvardit, nga i cili kanë dalë 8 presidentë amerikanë dhe 40 fitues të çmimit “Nobel”. Ishte mars i vitit 1996, kur unë i preka me dorë fletoret me lëndën shqiptare mbledhur nga Albert Bates Lord, në bibliotekën e Harvardit e dyta për nga madhësia pas Bibliotekës së Kongresit. Gjatë atyre ditëve të paharruara në Cambridge të Bostonit, si i ftuar i familjes së Albert B. Lordit, dita më emocionuese ishte vizita në varrezat e qytetit për plotësimin e një pengu, por edhe një detyrimi moral ndaj këtij shkencëtari dhe miku të shquar. Zbrita nga makina dhe shkova drejt varrit të Lordit. Shpërndava lulet e sjella dhe, me plot emocion thashë “Dear profesor Lord. I kept my promise. I have come from Albania, to meet You...” (I dashur profesor Lord. E mbajta premtimin. Kam ardhur nga Shqipëria e largët të takohem me Ty.) Dhe i përplotur shtova...”Të ndritë shpirti, i nderuar profesor Lord”.

Përgatiti: Kastriot Kotoni



Arsimi dhe kultura në qytetin e Voskopojës në shek. XVIII

nga DHIMITËR S.
SHUTERIQI

Në shek. XVIII, një sërë qytetesh shqiptare si Shkodra, Prizreni, Prishtina, Elbasani, Berati, njohën një zhvillim kulturor të dukshëm për atë kohë të feudalizmit dhe të pushtimit osman. U pajisën me shkolla dhe me vepra të arkitekturës artistike. Ky zhvillim u duk mirë në qytetin malor të Voskopojës, një nga më të rëndësishmit e vendit.

Voskopoja, sot fshat në jugperëndim të Korçës, në sajë të zejtarisë dhe të tregtisë, që nga fundi i shek. XVII, kishte marrë trajtën e një qyteti që po shkonte shpejt përpara. Dëshmi të ndryshme, edhe bashkëkohëse, japin deri në 50.000 banorë. Shifrat e teprojnë. Por nuk duhet të kenë qenë më pak se 25.000-30.000 banorë. Qyteti banohej nga vllehtë, por midis krahinave shqiptare, Voskopoja ka pasur, kuptohet, edhe një pakicë shqiptarësh. Këtë e tregon edhe toponimia dhe antroponimia e vjetër dhe e re e saj.

Kulmin e lulëzimit, ky qytet e arriti në vitet 1720-1769. Ndryshe nga qytetet e tjera, që administroheshin dhe shfrytëzoheshin nga ajanët feudalë, Voskopoja gëzonte njëfarë autonomie: ajo administrohej nga koxhobashët e vet, të cilët vareshin nga organet e pushtetit qendror osman. Një rrethanë e tillë lejoi që mbifitimi i realizuar të shkonte, në pjesën më të madhe, në dobi të zhvillimit zejtar e tregtar të qytetit. Nga ana tjetër, duke reshperuar dendur me vendet e Ballkanit e të Evropës Perëndimore dhe Qendrore, voskopojarët krijuan atje agjenci të tyre, më pas edhe disa koloni, si në Vjenë e në Budapest, në Mishkolc etj., të Perandorisë Austro-Hungareze. Prej këtyre kolonive, që kishin lidhje të vijueshme me vendlindjen, Voskopojën, por edhe me qendra të tjera tonat në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, depërtuan ndikime të ndryshme kulturore-mendore të Evropës së përparuar.

Fakti që popullsia e qytetit ishte e një feje, ortodokse, favorizoi një zhvillim më unitar kulturor, se në qytete tonat të tjera. Voskopoja u bë një nga qendrat më të përparuara të Shqipërisë, por edhe të Ballkanit në shek. XVIII. Dhe ka qenë ky edhe shkaku i katandisjes së shpejtë të saj në gjendjen e një fshati, e tepërmja me 1.000 banorë.

Sulmet e përsëritura grabitqare të feudalëve rrotull, në atë kohë anarkie feudale, shkaktuan rrënimin katastrofal të qytetit aq të përparuar. Sulmi më i rëndë ka qenë ai i vitit 1769. Shumica dërmuese e voskopojarëve morën arratinë dhe më s'u kthyen, por u përndanë dhe u vendosën nëpër Ballkan, si te fqinjët në Greqi dhe në Maqedoni, por sidomos në viset danubiane, në ato austro-hungareze dhe rumune etj.

Në fillim të shek. XVIII, në qendrat jugore të Shqipërisë, arsimi grek nisi të përhapet më shumë se në të kaluarën. Ortodoksët ballkanas ndiqnin atë arsim, të cilin osmanët e lejonin për ta, ndërsa arsimin shqip e ndalonin. Shkolla greqishte është çelur më 1710 në Voskopojë. Në atë shkollë mësonin jo vetëm fëmijët e qytetit, por edhe nga krahinat përreth, disa edhe nga më larg. Shkollën e drejtonte kleri dhe mbahej me mjetet

financiare të esnafëve dhe të tregtarëve të qytetit. Për t'iu përgjigjur nevojave në rritje të zhvillimit ekonomik të banorëve, shkolla fillore e Voskopojës u ngrit më 1740 në shkallën e një gjimnazi dhe u quajt Akademia e Re, duke marrë tiparet e një shkolle laike.


Më 1720, qyteti ishte pajisur edhe me një shtypshkronjë, e vetmja në Perandorinë Osmane. U shtypën aty libra fetaro-kishtarë dhe ndonjë libër mësimi.

Zhvillimi i arsimit dhe i kulturës në Voskopojë ndodhi nën ndikimin e lëvizjes iluministe të Evropës Perëndimore, ku prinin mendimtarë si Volteri, Rusoi dhe Didroi me shokë. Sidoqoftë, kjo lëvizje e përparuar gjeti kushte mjaft të vështira zhvillimi në rrethanat e sundimit feudal në Shqipëri. Ndër intelektualët e atyshëm, zakonisht klerikë, thuajse nuk patën ndikim idetë antifeudale dhe antiklerikale të iluminizmit evropian, por kryesisht idetë e racionalizmit të shekullit të mëparshëm, ato të Dekartit, Malëbranshit e të Lajbnicit me të tjerë, që kërkonin pajtimin e shkencës me fenë, ndonëse e theksonin fort parimin e vlerës së arsyes – “ratio”. Këto ide, në Perëndim kishin luajtur një rol shumë të ndjeshëm, porse tani ishin kapërcyer nga idetë iluministe, që ishin edhe më të guximshme.

Lëvizja mendore në Voskopojë ka përfaqësuar një etapë ende të pazhvilluar plotësisht të racionalizmit. Prapë, me gjithë kufizimet e saj, ajo shënoi një hap me rëndësi në vendin tonë, në krahasim me misticizmin, si edhe me skolastikën aristoteliane mesjetare, që deri atëherë kishte zotëruar në Kishën e Lindjes. Ndër përhapësit e këtyre ideve në Ballkan ishin mendimtarë, si grekët Metod Antrakiti dhe Evgjën Bullgari me të tjerë, që u luftuan nga Patriarkana greke e Fanarit. Sevast Leontiadhi ishte rektori i parë i Akademisë së Re në Voskopojë. Nxënës të tyre kanë qenë vendasit Theodhor Kavaljoti, që drejtoi Akademinë pas Leontiadhit, apo Grigor Voskopojari, që ishte zëvendësrektor, si edhe autor e redaktor i librave që botonte shtypshkronja e qytetit, apo i dituri Mihal Gorari me të tjerë.

Theodhor Kavaljoti ishte një filozof që jetoi





në vitet 1728-1789. Na kanë arritur prej tij traktate si “Logjika” (1749), “Fizika” (1752) dhe “Metafizika”. Ai njeh objektivisht materien, por shfaqet për pajtimin e shkencës me fenë dhe pranon pikëpamjen metafizike të ekzistencës së një krijuesi të gjithësisë, Zotit. Në mbështetje të këtyre ideve, Kavaljoti luftoi ateizmin dhe materializmin, idetë e të cilëve ishin përhapur në zonat e Kishës Ortodokse në Perandorinë Osmane. Nga pikëpamja politike dhe shoqërore, rryma filozofike e pedagogëve të Akademisë së Re, sado e përparuar tani në Shqipëri, shprehte edhe dobësitë e lëkundshmërinë e borgjezisë sonë të vogël zejtare dhe tregtare, e cila, për të siguruar gjendjen e saj ekonomike, kënaqej me kërkesën për zbutjen e regjimit feudal dhe nuk shtronte çështjen e përmbysjes së tij, siç ndodhte në Evropën e përparuar, apo kishte ndodhur edhe përpara Revolucionit Francez të vitit 1789.

Prapë, bartësit e ideve iluministe ranë ndesh me Patriarkanën e Stambollit dhe me Malin e Shenjtë, që ngulmonin në paprekshmërinë e traditave dogmatike të kishës në fushën e arsimit e të kulturës. Por idetë e reja përparimtare, sadokudo, depërtonin në shkollat që u shumuan ndër të krishterët e Shqipërisë së Mesme dhe të

Jugut, edhe pse këto qenë nën drejtimin e klerit. Ato ide i bëri të vetat edhe një pjesë e avancuar e vetë klerit, që luftoi dhe u rrezikua për to nga kisha. Ndërsa, nga ana tjetër, gjuha shqipe – në Voskopojë edhe vllahishtja – mësoheshin në njëfarë mënyre në shkollë, për t’i shërbyer mësimin të gjuhës së shkollës, greqishtes, gjuhë kulture e ortodoksëve të Ballkanit, apo shërbente shqipja pjesërisht edhe si gjuhë e kishës.

Kultura në Voskopojë shënoi një hap me rëndësi në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Duke futur shkencën pozitive në programet mësimore, ajo i dha goditjen e saj konservatorizmit të kulturës feudale dhe kontribuoi në lindjen e një iluminizmi shqiptar. Voskopoja u bë një qendër ndikuese edhe për viset përfaqshues, por edhe më larg, në Greqi e në Maqedoni. Vinin të mësonin aty djem nga Vithkuqi, Berati, Elbasani dhe nga gjetiu. Ata pastaj bëheshin mësues në vendlindjet e tyre. Të tillë kanë qenë Theodhor Haxhifilipi ose Dhaskal Todhri i Elbasanit, Kostë Ikonimi i Beratit, Evstrat Vithkuqari me shokë, që vepruan në shek. XVIII-XIX.

Duke qenë midis malësive të Korçës, në Voskopojën vllahe banuan edhe shqiptarë. Disa prej tyre u bënë më veprimtarë e më të njohurit

e personaliteteve në atë qytet. Kështu Theodhor Kavaljoti, që, siç e tregon emri i tij, por edhe shqipja që ai shkroi (me elemente të dialektit verior), ishte i një familjeje me origjinë nga Shqipëria e Mesme, kavajas. (Kavaja, fill më parë se shek. XVIII, thuhej edhe Kavaljë). Grigor Voskopojarin e hasim në krye të shekullit në Berat, nga duket se ishte.

Për të ndihmuar në mësimin e greqishtes, gjuhë e shkollës, në veprën e tij “Protopiria” (libër fillestare mësimi, Venedik, 1770), Kavaljoti botoi edhe një fjalor tri gjuhësh, me mbi 1.000 fjalë greqishte, vllahishte dhe shqipe të krahasuara. Edhe voskopojari Dhanil Adam Haxhi (rreth viteve 1754-1825), në “Isagogjinë” e tij (mësim fillestare, Venedik, 1802), rreshton bisedime të krahasuara në po ato tri gjuhë.

Në vitin 1762, Grigor Voskopojari, që pati qenë zëvendësudrejtor i Akademisë së Re (fundi i shek. XVII-1772), kishte përfunduar shqipërimin e të dyja Dhjatave (të së Vjetrës e të së Resë). Ishte ky një aksion shumë i madh kudo që të përkteheje në gjuhën e vendit librat bazë të kishës. Pjesë nga Dhjatat gjejmë shqip të “Meshari” i Gjon Buzukut, libri i parë në gjuhën tonë. Kisha pjesërisht thuhej me kohë edhe shqip. Kështu vazhdoi edhe në shek. XVIII, edhe më pas. Duke qenë shkolla e drejtuar nga kleri, në procesin mësimor hynte dhe shqipja, së pari përmes teksteve fetare, që zinin vendin më të madh në programet, por edhe përmes lëndëve të tjera, për t’i kuptuar më lehtësisht. Në tekstin e Theodhor Bogomilit (njohur më shumë si Anonimi i Elbasanit), i shek. XVII, ka edhe një predikim të lirë fetar. Dhaskal Todhri na ka lënë edhe një fabul të shqipëruar të Ezopit. Kostë Ikonimi ka edhe ai tekste trigjuhësh (në greqishte të vjetër, në atë të re dhe në shqip). Këto tekste i ka përdorur edhe mësuesi vithkuqar Kostë Cepi (i shek. XVIII-XIX), prej të cilit i njohim të kopjuara. Ai ka dhënë mësim jo vetëm në vendlindje, por edhe në Elbasan e gjetiu.

Grigor Voskopojari dimë se shkruante me një alfabet origjinal, që e kishte shpikur vetë për shqipen, sikundër edhe Bogomili përdorte një alfabet origjinal të vetin për shqipen që shkroi. Të njëjtën gjë bëri edhe Todhri, ndofta nën ndikimin e Bogomilit, por edhe të Grigorit, të cilin e pati mësues në Voskopojë. Përdori edhe ai një alfabet origjinal, që e shpiku vetë e që u përhap edhe në disa njerëz në Elbasan, të cilët lexuan e shkruan me alfabetin e tij. Njihen edhe të tjera alfabete origjinale të shqipes në Shqipërinë e Jugut, si në Gjirokastrë, në Janinë etj. Janë fakte me rëndësi për krenarinë e të qenit shqiptar e të shqipes si gjuhë më vete, që donte pra edhe një alfabet më vete. Grigori i përmendur ka qenë ndër të diturit kryesorë të shek. XVIII. Ai u bë kryepeshkop i Durrësit dhe u njoh edhe si Grigori i Durrësit. Ka jetuar edhe në Elbasan.

Kështu, Voskopoja ka qenë edhe një qendër e lëvrimin të shqipes. Atë nuk e shkruan vetëm Kavaljoti, Adam Haxhiu dhe Grigori, por sigurisht edhe të tjerë, që kur arriti të shqipëroheshin Dhjatat në atë qytet, të përdorej jo vetëm alfabeti grek, por edhe një alfabet i krijuar posaçërisht për shqipen.

Duke qenë një qendër ku u mësua greqishtja, Voskopoja nisi të luante edhe një rol në shkrimin e shqipes në krahinat e Korçës, ku dimë se shqipja shkruhej edhe gjetiu, p.sh., në Vithkuqin pranë, prej ku do të jetë një nga prekursorët e Rilindjes shqiptare, Naum Veqilharxhi.

Me dhembjen për veten ngarkuar në kurriz

Për dramën LETRAT bazuar mbi tregimin e Ylljet ALIÇKËS

nga Arta MARKU

Janë disa personazhe letërsie që të shenjojnë. Paharrueshëm. Pastaj, të shfaqen paparashikueshëm, sa herë diçka prej përditshmërisë i provokon. Kështu edhe personazhi i **Markut** që e kam zbuluar vite më parë në një tregim të Ylljet Aliçkës. Por, kush është Marku? Pse m'u gërvishet në lëkurë profili i tij?

E kam lexuar, pa asnjë përjashtim, letërsinë e Aliçkës, qysh në botimin e parë të librit të parë, që asokohe kishte titullin e përgjithshëm **Tregime**. Sot nuk di të them nëse tregimin **Letra** e hasa për së pari te botimi me titull **Tregime** apo ai me titullin **Parullat**. Por ç'rëndësi ka. Fundja janë dy libra me të njëjtën përmbajtje edhe pse tituj të ndryshëm. Në fakt, në kujtesën time, tregimi është ruajtur me titullin **Abetarja** e ndoshta është lojë tipike kujtese. Por edhe kjo, më duket, nuk ka rëndësi. Ama, e sigurt është se **Marku** i atij tregimi më rezultoi një personazh plotësisht i pashlyeshëm. Siç thashë, nga ata që gërvishnin dhe lenë shenjë. Historia e tij origjinale, unike, e bën të tillë. Një burrë i vetmuar, që e kam perceptuar si të vjetër në moshë edhe pse mund të mos ishte saktësisht i tillë. Një burrë që shkrihej me dimrin, me errësirën, me kohën e keqe, nën shiun dhe bubullimat e së cilës vejevinte brenda një nate të gjatë, sa nga banesa e tij tek dhoma e mësuesit nga qyteti.

Ja historiza me pak fjalë: Marku, kishte nevojë për një shtëpi. Kur binte shi, sidomos kur binte shi, për të nuk kishte ndryshim në ishte jashtë apo brenda. Ndaj kishte nevojë për një shtëpi. Por duhej të formulonte një kërkesë të cilën, më pas, do ta dorëzonte në zyrat e shtetit. Kurse ai, nuk dinte në shkruante.

Mu në mes të një nate të errët, që të vetmin ndriçim kishte dritën e fortë të vetëtimave të shpeshta, atij i vetëtim idea se mësuesi mund të ishte drita e shpresës së tij. Dhe niset. Shiu më mirë që bije. Le të bjerë. Fundja biografia e tij nuk është aq e bardhë dhe më mirë nëse fshatarët, që shiu i ka mbyllur brenda, nuk e shohin tek hyn e del në dhomën e vogël të mësuesit nga Tirana.

-Ma shkruaj një kërkesë mësues. Kam nevojë për shtëpi. Ma shkruaj kërkesën. Dëgjoje jetën time. Po ta rrëfej...

Jashtë shiu vijon të bjerë me rrëshkë. Me zhaurimën e tij në sfond që përzihet me kërcitjen e druve që digjen në sobë, teksa Marku rrëfen, mësuesi shkruan. E harton kërkesën. Ai jo thjesht di të shkruajë, por di t'i vendosë fjalët krah njëra-tjetrës si sumbulla të vogla rubini me një shkëlqim lëbyrës.

-Çfarë ke shkruar mësues? Lexoma letrën!

-Dëgjoje Mark...

Dhe mësuesi fillon të lexojë. Papritmas befasohet nga sumbullat e lotëve kësaj here, që Markut i shkasin teposhtë faqeve e i pikojnë

nga mjekrra.

-Çfarë ke Mark?!

Por, fshatari i vetmuar qenkësh duke "zbuluar" jetën e vet, e zeza mbi të bardhë, në një letër e cila duhet të jetë kërkesa për këshillin që t'i ndërtojë atij një shtëpi të re. Se Marku nuk ka shtëpi. Se jashtë bije shi. Se Marku vetmitar e i varfër ka nevojë për shtëpi.

Ta marrësh jetën tënde, ta vësh para syve si të jetë jeta e tjetërkujt e të ndjesh lotët të të djegin faqet... A nuk është e papritur?

Ylljet Aliçka është identifikuar gjithnjë në letërsinë e vet me tonet e theksuara të humorit. Humor i errët, i zi shpeshherë. Ama humor që teksa e bën leximin të shkasë, varësisht ngjarjes që rrëfëhet, të ravijëzon një buzëqeshje që endet në buzë. Kurse historia e Markut është disi ndryshe. Është e dhimbshme. Pa humor, pa cinizën. Është thjesht tragjike. Është filozofike gjithashtu. Se vetëm tragjizmi nuk do të mjaftonte. **Është njeriu përballë vetes.** Është dhimbja që ndihet më e thekshme tek e merr në duar dhe e sheh ballazi si të jetë e tjetërkujt duke qenë e jotja gjithsesi.



Një mëngjes të dhjetorit që sapo shkoi, tek ecja rrugës, m'u përvijua Marku. E çuditshme, s'di ç'mendoja që më shkaktoi një rrëqethje.

Si Marku i Ylljetit – mendova, – që rrëqethet tek dëgjon jetën e vet, më rrëqethi dhe mua mendimi që më kaloi vetëtimthi... Vazhdova rrugën pa më shkuar në mendje se Marku po më ndiqte. S'kaluan dy orë dhe Ylljeti më la në dorë një ftesë.

-Eja në teatër, – më tha.

Marku sërish! Me shkronja të mëdha në ftesë, lexova: **LETRA**.

Mbrëmjen e të njëjtës ditë, gjeta vendin tim në sallën e teatrit. Përballë, në qendër të skenës një karrige dhe një llampë që varej mbi të duke u lëkundur. Një djalë i ri fishkëllente lehtas një motiv. Ishte vetëm në skenë dhe aty për aty hamendësova një ngatërresë titujsh a personazhesh. Tregimi LETRA (në kujtesën time ruajtur me titullin ABETARJA) kishte dy personazhe në fakt. Kishte Markun e pashlyeshëm dhe mësuesin që s'ka si të jetë tjetër, veçse Ylljeti vetë, i kohës së "shkurtër", siç e ka zakon të thotë me humor, prej 15 vjetësh mësues fshati... A mos ndoshta regjisori Salvatore Tramacero qenkësh intriguar nga një tjetër tregim dhe jo nga historia e Markut?

Apo duhet të pres dhe pak?

Ndoshta Roerd Toçe, që ka dalë në skenë para se publiku të fillojë të mbushë sallën dhe fishkëllan lehtas një motiv muzikor, ulur në karrigen metalike mu në qendër të skenës së zbrazët, është thjesht mësuesi. Ja, sa të trokasë dera, në mes të zhurmave të shiut dhe bubullimave, do të hyjë Marku.

Dhe prita.

Në sallë zërat e publikut nisin e fashiten teksa fillojnë e dëgjohen gjithnjë e më të forta zhurmat e shiut dhe bubullimat. Tashmë jemi futur në atmosferë. Jashtë sallës së teatrit bie shi i vërtetë. Por zhaurima që dëgjohe brenda, bashkë me bubullimat e forta, janë të



shfaqjes. Aktori vazhdon të fishkëllejë të njëjtin motiv. Dhoma e tij gjysmë e errët është ndriçuar zbehtë nga një llampë e vetme që varet në qendër të hapësirës.

Bie dera. Në fillim lehtë e më pas më fort.

-Kush është?

-Marku! Jam Marku.

Tregimin mbi të cilën është mbështetur kjo vënie në skenë e paskam identifikuar saktë. Askush nuk hyn nga jashtë. E megjithatë dikush hyn nga jashtë. Është pikërisht Marku i tregimit të pashlyeshëm. Titulli s'ka rëndësi. (Ndonjëherë është thjesht një kapistall – s'di cili shkrimtar ma pat thënë në një intervistë). Thjesht tregimi që e kam lexuar në vitin e largët 1998 është ai që tani do ta shoh të ngjitur në skenë. Aktori është vetëm. Është ai, herë mësues e herë Mark. Monolog, dialog, monolog, dhe pastaj sërish dialog e monolog. Rrëfim aty këtu. Gjithçka nga Roerd Toçe. I vetëm në skenë.

Marku shkon e vjen. Rrëfen. Mësuesi shkruan. Marku kërkon ta dëgjojë historinë e vet. Mësuesi lexon. Marku qan, ikën, vjen sërish dhe kërkon veç të dëgjojë jetën e vet të mjerë. Të ndjejë dhembjen deri në kockë... dhe kështu deri në fund... **DHEMBJE PËR VETEN.**

Historia është e jashtëzakonshme. Aktori herë është mësuesi, herë Marku e herë zëri rrëfimtari i ngjarjes. Pastaj sërish Marku...

Në dhomën e errët dhe të ngrohtë të mësuesit historia vetëm sa fillon. Ajo vijon më pas e gjatë, e gjatë. Me Markun ngarkuar me dhembjen në kurriz... **DHEMBJEN PËR VETEN...** Me një letër në dorë hyn e del... Më vonë, me të njëjtën letër sillet rrrotull oborrit të shkollës:

-HEJ TI, A MA LEXON LETRËN?

-MA LEXO LETRËN!

-LEXOMA LETRËN PRA!

Fëmijët e shkollës dinë të lexojnë... por Marku kërkon më shumë. Akoma më shumë. I duhet një ABETARE (ja pse tregimin e Markut kujtesa ma paskësh ruajtur me titullin ABETARJA) ... për të mbajtur gjithnjë dhembjen e vet si një diamant të zi ndër duar, që ta ketë përballë, që ta shohë, që ta lexojë vetë dhembjen e vet... Letrën nuk e ka dorëzuar në këshill. E ka ruajtur për vete. I duhet me vete, ta ketë përgjithnjë. Është jeta e tij. Vlen më shumë se një shtëpi.

Tregimi për Markun, i botuar këtu e 21 vjet të shkuara në përmbledhjen me proza të shkurtra me titullin e përgjithshëm *Tregime*, në të vërtetë titullohej **"NJË HISTORI FSHATI"**. Në fillim të dhjetorit të shkuar u ngjit në skenë me titullin **LETRA**. Historia është po ajo, personazhi po ai. Vetëm se nuk bëhet fjalë për një lexim që emocionon lexuesin e mbështetur mbi një kolltuk mbështjellë nga heshtja e një dhome. Është një shfaqje teatri. Mbështjellë nga heshtja e sallës. Një shfaqje mbresëlënëse, po aq e pashlyeshme sa tregimi në zanafillë, me personazhin e tij origjinal dhe unik.

"E para është fjala". Por duhet regji e duhet interpretim që të bëhet TEATRI. Dhe teatri ishte. I jashtëzakonshëm!

Ishte vetëm një mbrëmje fillimdhjetori.

Por, fundi i janarit dhe javët e para të shkurtit, LETRËN e Ylljet Aliçkës me regji të Salvatore Tramacere dhe interpretim të Roerd Toçes do ta ngjisë sërish në skenë. Në Teatrin e Metropolit. E unë do të shkoj ta rishoh. Të rigjej një copëz filozofi-jete, si një llampë që e mban në dorë e lëshon dritë. Ka diçka magnetike, teksti, regjia dhe loja që e bëjnë spektatorin e teatrit të sillet për një çast ngjashëm me personazhin: të kthehet në sallën e teatrit krejt si MARKU që kërkon t'i rikthehet jetës së tij të shkruar në një LETËR. Janë disa personazhe letërsie që të shenjojnë. Paharrueshëm...

“Pena është më e fortë se shpata”

Rreth romanit “Labirinti i shpirtrave” nga Carlos Ruiz Zafón



Labirinti i Shpirtrave është romani i katërt i tetralogjisë së Carlos Ruiz Zafón-it, që zhvillohet në universin letrar të Varrezave të Librave të Harruar. Në libër rimerren temat dhe personazhet e njohura edhe në romanet e mëparshme, ndërsa vjen si një risi që i përcjell vlera të reja romanit, epërsia e një femre fatale, e cila sfidon maskilizmin e fshehtë të tri romaneve të fundit. Alisia Gris është detektive e policisë sekrete spanjolle dhe përfaqëson gjithçka që një grua në Spanjën e Frankos nuk duhet të ishte: autonome, seksi dhe gjakftohtë, edhe në situata të rënda. Përmes Alisas, Labirinti i Shpirtrave shtron një pyetje të rëndësishme: kush është përgjegjës për "korrigjimin e gabimeve" të nesërmen e rënies së një regjimi politik të korruptuar?

Në fillim të *Labirintit të Shpirtrave*, Ruiz Zafóni shpjegon se ai i shkroi romanet e sagës Varrezat e Librave të Harruar, në mënyrë të tillë, që të lexohen në çdo lloj radhe. Qëllimi është të lejojë lexuesit "të eksplorojnë labirintet e historive përgjatë rrugësh të ndryshme që, kur kryqëzohen, të çojnë në zemrën e rrëfimit." *Hija e erës* është romani i parë i kësaj sage, që ndjek historinë e Daniel Sempere, teksa heton për një autor misterioz të Barcelonës, me emrin Hulián Karaksi. Libri tjetër, *Loja e Engjëllit*, zhvillohet afërsisht një brez më parë dhe përqendrohet te David Martini, një shkrimtar i shkëlqyer, por mendërisht i brishtë. *I burgosur i Qiellit* është libri i tretë në këtë seri. Është historia e Fermin Romero, një personazh popullor nga *Hija e Erës*, i burgosur politik në kështjellën e Montjuic.

Labirinti i Shpirtrave zhvillohet në vitin 1959-60 në Spanjë, kryesisht në Barcelonë, e cila mbizotëron gjithë skenën, ashtu siç ndodh në çdo roman tjetër të kësaj sage. Zhdukja misterioze e ministrit të Kulturës, Mauricio Vallsit, në nëntor të 1959-ës, është "preteksti" nga merr jetë gjithë ngjarja. Alisia Gris është ngarkuar ta hetojë këtë çështje, së bashku me një polic të quajtur Huan Manuel Vargas. Puna e tyre si detektivë i çon nga Madridi në Barcelonë, ku zbulojnë sekretet e harruara prej kohësh, me ndihmën e familjes Sempere. *Labirinti* është organizuar sipas kronologjisë alternative të titulluar sipas lutjeve liturgjike dhe meshës së rekuemmit katolik: *Dies Irae*, *Kyrie*, *Agnus Dei*, *Libera Me* dhe *In Paradisum*. Kjo strukturë tregon me forcë mënyrën se si e kaluara është ende e pranishme për personazhet në roman.

Një mënyrë për të lexuar Labirintin është ta

shohësh atë si një koment në lidhje me rolet e leximit dhe të shkrimit. Jo vetëm autorët dhe lexuesit figurojnë dukshëm në roman, por edhe librat. Në këtë mënyrë, romani na jep plot mençuri këshilla për leximin në universin e Varrezës së Librave të Harruar: duhet të jesh një detektiv letrar, për të bashkuar të gjitha historitë së bashku.

Një mënyrë tjetër për të lexuar romanin është të kujtoshe një pyetje që lind shpesh në veprën e Ruiz Zafónit: kush është përgjegjës për gabimet e së kaluarës? Personazhet në Hijen e Erës, Lojën e Engjëllit dhe I Burgosuri i Qiellit shpesh janë në mëshirën e entiteteve të fuqishme si të aristokratëve të pasur, zyrtarëve të korruptuar të qeverisë dhe konvencioneve shoqërore prepotente. Labirinti i Shpirtrave paraqet personazhe që jo vetëm luftojnë pabarazinë, por edhe e demaskojnë atë. Në fund të romanit, Alicia Gris merr si dhuratë një penë të bukur e të çmuar, që sipas gjasave, duhet të kishte qenë e Viktor Hygoit. Ajo e përdor atë vetëm dy herë. Herën e parë, ajo shkruan emrin e saj në një dokument. Herën e dytë e përdor si thikë, duke goditur dikë. Asnjëherë citati i famshëm i Edward Bulwer-Lytton "pena është më e fortë se shpata" nuk ka qenë më i vërtetë dhe, mbase, më i domosdoshëm.

Labirinti i Shpirtrave dhe e gjithë kjo sagë është tashmë në duart e lexuesit shqiptar. Ky roman brilant, model i një stili të pakrahasueshëm, shkruar nga autori më në zë bashkëkohor spanjoll është botuar nga shtëpia botuese "DITURIA", si pjesë e projektit "Histori fatesh njerëzore", realizuar me mbështetjen e programit Europa Krijuese të Bashkimit Europian.

Elisa Cogbill-Seiders
Universiteti i Nevadas, Las Vegas
(Përktheu Ana Sheldia)



TE VARRI I DANTES

tregim nga

Ndue Dedaj

Baca urtak bëri një fotografi me Danten, shkroi një epitaf në një pergamenë prej lëkure dhie, që e kishte përgatitur me duart e veta, kur po bëhej gati të nisej nga Shqipëria për në Itali, e vendosi mbi varrin memorial dhe u ul gjithë venerim përbri tij i menduar...

Ai kishte një emër, si çdokush, por në atë qytet naftëtarësh të gjithë e thërrisnin Bacë, kështu që emri i tij, Pal përmendej përherë e më pak. Mund të duket e habitshme se si e kishte fituar atë emër nderues, që nuk e gëzonte asnjë tjetër, një njeri që prej shtetit merrte herë pas herë goditje politike, por që nuk ia kishin vrarë buzëqeshjen bujare, që i buronte prej thellësisë së shpirtit. Goditja e fundit kishte qenë para tre vjetësh, kur e kishin hequr nga Biblioteka e Naftës në Qytetin Stalin, që ai e kishte themeluar vetë, si poliglote që ishte dhe e kishin çuar për riedukim në fonderinë e çelikut në Patos, ku temperatura e shkrirjes ishte e papërballueshme. Por ai ishte mësuar me këto shkandulli (të këqia) të zyrave politike, e vetmja gjë që donte në këtë botë ishin njerëzit, të cilëve bënte çmos t'iu gjendej me ç'mundej, sidomos me libra. Bir i virtutshëm e i përkorë i Munellës që e kishte lindur, me një pamje sa kreshnike, aq engjëjlore, dukej se ishte duke ecur asaj rave jete qysh nga koha e Shën Palit...

Ishte hera e parë që shkonte në Itali dhe shkilte në Ravenë, ku kishte djalin emigrant. Në mendje i erdhi historia e vet e 17 viteve më parë, kur Shqipëria ishte ende e vetëngujuar. Kishte harruar se e kishte atë libër në bibliotekën e tij, ndoshta ngaqë "Lahuta" kishte mote që ishte përjashtuar nga bibliotekat, më mirë thuaj nga ndërgjegjja e shtetit, si e dëmshme për njeriun e ri. E kur nuk e mbante qeveria, si mund ta mbante ai, një njeri i dyshimtë, që partia e kishte hedhur prej kohësh pas krahëve? Kishte pesëmbëdhjetë vjet që ishte përjashtuar nga radhët e saj, ia kishin marrë taserën me ceremoni dhe nuk ia kishin kthyer më. Shkurt, ai ishte një i pushkatuar politik, siç thuhej për të përjashtuarit nga partia. I kishte shkruar letra të parit të Byrosë Politike në Tiranë, por ai nuk kishte denjuar t'i kthente as dy rreshta përgjigje. Për atë atje lart, në zenitin e pushtetit, që i shkonte mendja të matej me diellin, të gjithë poshtë tij ishin miza që ai i shtypte me gishtin e vogël të dorës. Ani se Pal Nredia pas Luftës ishte diplomuar për sinoptikë në Beograd e, pasi qe kthyer në atdhe, kishte drejtuar për disa vite fluturimin e avionëve ushtarakë në areodromet e vendit.

Baca u kujtua për "librin e mallkuar", siç e quanin ata të agjitpropit (agjitprapit - thoshte ai) komunist vetëm një mbrëmje, kur miku i tij i ri, Visari, me të cilin punonte në repartin e fonderisë, me shqetësimin që i lexohej në sy, i tha:

"Bacë... e di që do të duket e çuditshme... e pamundur... por atë... *Librin* duhet me e djeg?!"

"Ç'po thua, o Visar djali?"

"S'di sa e ke vënë re, por mua më duket se të janë vënë pas hafijet?"

"Diçka kam vërejtur, kohët e fundit, ca njerëz si

hije rreth e qark meje, sy të dyshimtë, ndonjë provokim kalimthi!..."

Djaloshit diçka i kishin zënë veshët, rastësisht, një ditë në korridoret e zyrave të Administratës, ku ai kishte shkuar të dorëzonte kërkesën për të konkuruar për aktor në Institutin e Lartë të Arteve. Kishte një njollë në biografi, por shpresonte ta kapërcente me talentin në konkurim. Baca ishte mbështetësi i tij kryesor, i cili jo vetëm e nxiste të mos thyhej, por dhe e ndihmonte në përgatitjet për konkursin, falë njohurive që kishte për teatrin.

"E kuptova merakun tënd, mor bir. Do ta zhduk *Librin* që thua ti, por më duhen tre muaj kohë!"

"Tre muaj?!....."

"Po, po, veç pas tre muajsh është e mundur!"

"Bacë! Ti asnjëherë nuk ke qenë kështu, hermetik...?"

"Nuk është se dua unë, por s'mund të zhduket "Lahuta" ashtu, tak-fak, si të mos ishte!"

"Një e futur në stufë dhe u krye! Pse u dashkan tre muaj? E kuptoj se të dhemb, është si të flakësh një pjesë të vetes, por më mirë ai libër i djegur, se ti në djall?!..."

"Ty të falemnderës fort, or mik, por më duhen tre muaj!"

Me kaq u mbyll ajo bisedë, që për Visarin kishte qenë e pakuptimtë.

*

Truri i Bacës tash përbluante vetëm Lahutën. Gjithë jetën ajo vegël mahnitëse, veç me një tel e një hark, kishte rënë mbi rrashtin e atyre maleve. Ajo ishte aq e motmotshme në shkrepit e tij bjeshkëtar dhe përtej tyre, nëpër Ballkan. Në shekullin XX kishte ndodhur mrekullia e lahuta shqiptare ishte shndërruar në një libër prej qindra fletësh e mijëra vargësh. Ajo lahuta prej druri tash binte më pak dhe kjo prej letre ligjëronte më shumë. Deri sa ndodhi hataja e "Lahuta" e malcive e malcorëve do të shpallej armike e regjimit. "Më mirë një diversant në shtëpi, se sa atë libër!" - thoshin agjitpropët (agjitprapët) e partisë.

E tash a do të mundet ta nxinte zgrofi i tij të gjithën - Të buk'rën ketë Shqipni? Cubat. Oso Kukën. Prenë. Vraninën. Dekën. Dervish Pashën. Kuvendin e Berlinit. Ali Pashë Gucinë. Lidhjen e Prizrenit. Mehmet Ali Pashën. Lugatin. Marash Ucin. Kishën e Shnjonit. Urën e Rrzhanicës. Kasnecin. Kulshedrën. Qafë Hardhinë. Urën e Sutjeskës. Patër Gjonin. Lekët. Ndërmjetësinë. Tringën. Tbanat e Curr Ulës. Zanën e Vizitorit. Gjakun e Marrun. Kohën e Re. Xhumjetin. Dedë Gjo' Lulin. Luftën e Ballkanit. Konferencën e Londonit.



E kishte mësuar në fillim Lahutën prej gojës së t'et, i cili i binte në odën e burrave, në kullën e tij poshtë Gurit të Dragoit, sa herë vinin miq të largët prej Shkodre a prej Europe.

"Ndihmo, Zot, si m'ke ndihmue!"

Pesëqind vjet kishin kalue..."

Ishte i vogël asokohe dhe ende nuk e dinte se kishte një tjetër lahutë përpos asaj prej druri që i binte babloku, një lahutë prej letre, të cilën ai do ta merrte me vete ngado të vinte, edhe në Beograd, kur ishte student, të mbështjellë me kapakët e një libri rus me titullin "Frymë të vdekura". Ai burrë dhe Lahuta ishin bërë një dhe nuk mund të ndaheshin, si të ishte shndërruar ajo në lëkurën e tij. Njëri do ta merrte me vete tjetrin. O në qeli. O në varr. O në liri. Ndoshta kurrë më parë nuk kishte pasur një lidhje të atillë, mes një njeriu dhe një libri!...

Disa herë atyre netve e kishin mbuluar djersët e ftohta - a do t'ia dilte me e fut lahutën brenda trurit të tij? Sa herë kishte thirrë në ndihmë orë e zana që ta ndihmonin t'i raste në tru ato mijëra vargje.

I ishte dukur vetja se kishte hyrë në një pyll të errët e të frikshëm pa fund e pa anë. Vetvetiu i erdhën në mendje vargjet e Ferrit:

"Në mes të shtegtisë së kësaj jete

U gjeta në një pyll krejt errësi..."

Zoti kishte qenë me të. Ato 90 ditë do të ishin sprova e tij e pabesueshme, beteja për ta përbujtë brenda vetes atë shëmbëllesë të Shqipnisë së vjetër. Kur kishte mbërritur në dy vargjet e fundit, kishte hovur përpjetë:

"Si premtue kish' Perendia

Prap Zojë m'veti duel Shqipnia".

Trupi i tij tash ishte si ajo gurra e lashtë e vendlindjes që kurrë nuk do të shterrej e ndalej së gurgulluari mbi Fan e deri në det.

I kishte mbyllur dy kapakët e Lahutës, për të mos i hapur më.

*

Atë mbrëmje Visari, djaloshi jugor, ishte larguar me bafasinë e atyre fjalëve të Bacës, malësorit të fisëm veriak, që kishte ardhur i ri Jug e po mplakej mes naftëtarëve. Çfarë ishin ata tre muaj që i duheshin atij për të zhdukur Lahutën? Kur mund t'i venin nga ora në orë policët e t'i sokëllinin: "Në emër të popullit je i arrestuar".

Kaluan tre muaj pa folur më me Visarin për *Librin*. Sakaq në qytet u hap fjala se Baca, gati kishte djegur shtëpinë, duke dashur të shpëtonte një peliçe prej meshini, që i kishte pas marrë flakë, teksa thahej mbi stufë, të cilën e ruante që nga kohë kur kishte qenë jashtë shtetit. Ishte parë një tym i verdhë shtëllunga-shtëllunga dhe ishte përhapur gjithandej një erë e rëndë që të zinte frymën.

Ia behu Visari:

"Bacë, nuk po kuptoj ç'ka ndodhur! Thonë se desh je djegur vetë, duke dashur të shpëtosh një peliçe?..."

"Janë fjalë ato, mor bir, ti e di se fjalët e hallkut e birat e gardhit nuk mbyllen kurrë!"

"Po me Lahutën çfarë u bë?"

"Ai tymi... ishte i saj! E si mund ta digjia Lahutën, pa e gëlltitur të gjithën?"

Dhe Baca filloi të ligjëronte njëren pas tjetres këngët e saj. Tri ditë e tri net e prapë nuk kishin të sosur. Visari s'po iu besonte syve, as veshëve. Baca e kishte mësuar përmendësh "librin e mallkuar", ndaj i ishin dashur tre muaj... 16 mijë vargje i kishte përpirë. Ato nuk mund t'ia merrte më askush. Ishin të tijat. Mund të ulej dhe ta shkrunte "Lahutën" nga fillimi... Kurse djaloshi që do të bëhej aktor ndoshta një ditë do të luante në skenë rolin e *lahutëngrënësit* të pazakontë.

Ja, këtë histori Baca po ia besonte Dantes. Pse pikërisht atij? Se kishte mësuar në rininë e tij shumë nga këngët e "Ferrit" përmendësh? Se historia e tij kishte dalë nga njëri prej rrathëve dantesk?...

Këtë vetëm ai e dinte, e tash dhe Dantja, poeti i madh i botës, ku hekakeqët nga pushteti i gjashtëqind vjetëve, vinin e linin pengjet...

Kurrë nuk më kishte shkuar mendja se pas tre vjetësh me vrasësin tim, i cili dukej sikur më ishte hedhur në shkretëtirën e harresës. Kur e pashë në fillim, i thashë vetvetes: mos mendja më është ngatërruar aq shumë, saqë nuk jam në gjendje ta njoh? Disa çaste e kam vështruar njeriun për të cilin isha i sigurt se ishte vrasësi im. Zëri i brendshëm më tha: sa shumë paskësh ndryshuar! Qenka stërkequr e plakur shumë...

Ditën që më kishte vrarë, kishte përjetuar një kënaqësi të madhe, i bindur se nga shpirti kishte hequr një barrë të rëndë. Mirëpo gjërat nuk kishin shkuar siç kishte dashur të shkonin. Prej atij çasti unë gjithnjë e më tepër i shfaqesha në mendje, i shfaqesha në ëndërr, i shfaqesha edhe kur bënte dashuri me vajza të bukura. Trajta ime herë e gjallë, herë e vdekur, i shfaqej më së shumti gjatë natës e më pak gjatë ditës. Sapo shtrihej për të fjetur, e ndiente praninë time jo vetëm në një skaj të mendjes, por edhe në një skaj të dhomës. Kurrë nuk guxonte ta fikte dritën, i bindur se në velin e errësirës trajta ime do të ishte më konkrete. Dikush i kishte thënë se hijet e njerëzve të vdekur drita i bën të padukshëm, madje i zhduk edhe nga hapësira e mendjes. Sapo i bëhej sikur e kaplonte një gjumë i shqetësuar, trajta ime i shfaqej afër veshit. Pastaj i pëshpëritja do fjalë me zë të vrazhdë, të cilat ai nuk ishte në gjendje t'i dallonte nëse ishin të vërteta ose i trillonte mendja e tij. Ato fjalë i shkaktonin neveri të madhe në shpirt. Shpesh ngrihej nga shtrati i xhindosur.

Me mendje të shthurur e me sy të buhavitur vinte te varri im dhe më vriste me shtatë plumba, i bindur se herën e parë nuk kishte mundur të më vriste tërësisht. Gjatë rrugës teksa kthehej në shtëpi e ndiente veten të ngazëllyer, i bindur se kurrë më s'do t'i shfaqesha as në ëndërr, as në zhgjiëndërr... E vrava për herë të dytë atë njeri të mallkuar, thoshte me zë të shfrenuar derisa ecte i kalamendur rrugës gjysmë të errët. Pastaj lëshonte do qeshje krikëlluese. Pak para se të arrinte te shtëpia, zëri i mendjes i thoshte: ke harruar të bësh veprimin kryesor që do të të qetësonte edhe më shumë... Ngadalë, i dehur nga kënaqësia, kthehej te varri im e pastaj pshurrej duke qeshur marrëzisht. Me një zë të shfrenuar, thoshte: kur të vijë pranvera, asnjë lule të mos çelë mbi varrin tënd! Derisa e vështronte avullin e verdhë si dilte nga varri im, zemra i rritej sa një mal...

Kur hynte në dhomën e tij, fryma për pak nuk e lëshonte. Trajta ime i shfaqej në dy pjesë: njëra ishte e vdekur dhe tjetra e gjallë! Një zë i brendshëm i thoshte:

sa herë do ta vrasësh, ai do të shumohet si bimë e hidhur... E kaplonte pendimi pse më kishte vrarë për herë të parë e për herë të dytë. I kredhur në vorbullën e një dhembjeje të paanë, i betohej vetes se më nuk do të më vriste, madje edhe nëse shkoja te shtrati i tij dhe mundohesha t'ia nxjerrja të dy sytë... O Zot, thoshte derisa përpëlitej në shtrat tërë natën, tash po e kuptoj se më e mundimshme është të jesh vrasës sesa i vrarë! Tërë natën e kalonte në një gjendje të neveritshme, as i fjetur, as i zgjuar, as në ëndërr, as në zhgjiëndërr... Shtëpia e tij i shëmbëllente një varri në të cilin ishte varrosur për së gjalli...

Një ditë e ftoi mikun e vet më të besueshëm, të cilit i tha: më shumë po më shqetëson për së vdekuri sesa më ka shqetësuar për së gjalli! Miku i tij, pasi u krodh disa çaste në do mendime të thella, i tha: ndërroje shtëpinë! Ndoshta hija e tij nuk mund të të gjejë kudo që të shkosh.

Të nesërmen mori një shtëpi të bukur me qira në periferi për gjashtë muaj. Kur u zhvendos në shtëpinë e re me gjithë familje, e ndjeu veten të liruar nga një barrë e rëndë. Tash e tutje do të jetoj i qetë pa më shqetësuar ai i mallkuar, tha me vete i ngazëllyer. Mezi priti të vinte nata e të shtrihej për të fjetur, ngase prej se më kishte vrarë s'kishte mundur të flinte. Tërë kohën hija ime i shfaqej në imazh... Sapo e kaploi gjumi i parë, hija ime vetëm në eshtra iu shfaq afër shtratit. Disa herë me një zë të çjerrë e thërrisja që të zgjohej e të më vriste përsëri. Disa çaste vazhdoi të qëndronte si

në ferra pa e ngritur kokën nga jorgani. Pastaj disa herë e thërrisja në emër me një zë të llahtarshëm, me një zë që i shëmbëllente ulërimës së ujkut të tërbuar... Më thuaj pse më vrave, pasi asgjë të keqe nuk të kam bërë? Dikur u zgjua nga një gjumë i shqetësuar dhe pastaj me sy të zgurdulluar zuri ta vështronte hapësirën e dhomës. Me sytë e vagëlluar, nëpër të cilët sorollateshin do përfytyrime të vdekura, iu bë sikur përtej dritares e pa fytyrën time, një fytyrë të zbehtë që i shëmbëllente një kufome të cilën koha nuk kishte mundur ta dekompozonte. Kurrë në jetë nuk kishte parë fytyrë më të vdekur e as sy më të tmerrshëm që e vështronin me një urrejtje të madhe... Kjo fytyrë e shëmtuar, këta sy të verbër janë të rrejshëm, i tha vetvetes me zë të përvajshëm. Mendja ime e sëmure po i trillon. Kam frikë se së shpejti do të çmendem!

Të nesërmen u rikthye në shtëpi të vet. Atje çdo gjë i dukej e mbështjellë me një qefin të leckosur. Në çdo skaj e shihte hijen time të stërkequr, të deformuar, e cila e bënte të tmerrohej. Në netët e gjata, kur përpëlitej tërë kohën e gjumë nuk mund të bënte, më mallkonte me shpirt të copëtuar pse nuk e lejoja të bënte jetë të qetë as pas vdekjes. Pastaj e mallkonte edhe vetveten që kishte menduar se me vrasjen time do të lirohej përgjithmonë prej meje. E mallkonte edhe mikun e vet që i kishte thënë: nëse ti nuk ke guxim ta vrasësh këtë gjë, mund ta bëj unë nëse më jep një sasi të vogël të hollash, por edhe nëse më shpëton nga çdo e ligë që mund të më gjejë. Hija ime ia kishte vrarë gëzimin dhe një ditë do ta vriste edhe atë. Sa herë mundohej të mendonte për diçka, gjithnjë hija ime me sy të nxjerrë i shfaqej përpara, duke i shkaktuar dhimbje e mërzi. Disa herë xhindosej si një bishë e egër dhe pastaj lumin e mllefrit mundohej ta zbrazte duke pështyrë mbi fytyrën time. Mirëpo, pas pak hetonte se unë isha vetën përfytyrim, kurse pështyma i kishte rënë mbi fytyrën e tij. Një mendje e marrë i thoshte: ai po të pështyn edhe për së vdekuri, sikur nuk i ka mjaftuar të të pështyjë sa ka qenë i gjallë. Disa herë i thoshte vetvetes: më lehtë e kisha me të kur ishte i gjallë, sesa tash kur është i vdekur. Kur ishte i gjallë, mund t'i shkaktoja dhembje të madhe duke e rrahur sa herë të doja, duke e fyer me fjalë banale sa herë të doja, duke ia sharë nënën sa herë të doja... Tash, kur është i vdekur, s'mundem t'i bëj asgjë...

Kur kaluan tre vjet e ndonjë ditë më shumë, filloi ta ndiente veten se kishte filluar t'i nënshtrohej procesit të çmendurisë, i cili do të zgjaste edhe për tre vjet të tjerë. Një mesnatë kishte dalë nga shtëpia. Ndoshta ishte zgjuar somnambul. Ishte sorollatur nëpër do rrugë të zbrazëta pa e ditur nga ishte nisur të shkonte. Dikur kishte ardhur te varri im, ishte shtrirë mbi varrin tim dhe pastaj kishte filluar të dëneste me zë lutës. Ndoshta më lutej që ta falja. Ndoshta më fyente edhe më tutje më fjalë banale. Unë kisha vendosur që të qëndroja indiferent ndaj të gjitha sjelljeve të tij prej një njeriu të çmendur...



NATYRA NJERËZORE

tregime nga

Alida Frashëri (Bodini)

BLUZAT

Salloni i huaj me dritare shumë të larta është mbushur me njerëz të panjohur, veshur gjithë shije: bluza të holla mëndafshi ngjyrë kremi, me pikla të vogla të zeza.

Vetëm njëra prej grave, me trup të drejtë, hedh me një lëvizje të shpejtë mbi shpatulla një bluzë prej leshi krejt të hollë, pothuaj transparente.

Rri ulur dhe na shikon në heshtje me qetësi, sikur të mos jetë duke ndodhur asgjë.

Sikur të mos ishte duke ndodhur asgjë.

ADAPTI

E shoqja e shoferit të shkurtër nuk e kishte mbaruar akoma punën me shtëpinë, siç do të kishte dashur ta bënte. Ndërsa unë, me gjithë përpjekjet për të qenë i përpiktë në orar, vura re që u ndodha aty më shpejt seç duhej.

Përdhe ishte akoma gjithçka e lagur dhe grumbuj të vegjël rëre të përzier me ujë kishin krijuar pellgje, që zonja e shtëpisë po mundohej t'i sistemonte me një leckë me shkop, sikur trazonte miell misri në një tigan me ujë e vaj. E gjithë hyrja mbante erë qumësht gëlqereje e llaçi të freskët.

U mundova të bëja sikur nuk vija re gjë, por nusja dhe e vjehrra, që rrinin të dyja në mes të dhomës, ua ngulën sytë këpucëve të mia që shkelën kuturu duke u pllauritur nëpër pellgjet e vogla, gjoja për të mos bërë pis.

Ndërsa Adapti rrinte në një karrige, disi me vështirësi për shkak të trupit të tij katror, dhe buzëqeshje indiferent. Më ngacmoi menjëherë mënyra, por nuk thashë gjë. E kuptova se qe gabimi im që kisha ardhur aq herët, s'kisha ç'bëja, tashmë qe vonë.

Ata kishin marrë shtëpi të re: dy dhoma, një kuzhinë, aneks e banjë. Sado që dhomat qenë fare të vogla si kuti, ata dukeshin të kënaqur. Të paktën, më së fundi, banja nuk ishte më e përbashkët me komshiun; vetëm duhej të manovroje me pastrimin dhe kjo s'kishte fare të bënte me atë që shtëpia ishte e re.

Pas çdo pastrimi duhej të prisje sa të thahej përdhe, pastaj të hyje brenda.

Por fenomeni përsëritej sepse, edhe kur pastroje, vijonin të krijoheshin mbi pllakat e çimentos ata grumbujt e çuditshëm të rërës së ndërtimit përzier me ujë.

E hoqa mendjen nga tharja e përdhesë dhe paraqita punën për të cilën kisha shkuar. Disa formate letre të

trashë pasparture në ngjyrë qumështi, që do t'i përdorja si sfond kur të më vinte rasti. Të dyja gratë nxituan të më tregonin fotografitë e mëdha. U habita me cilësinë e tyre dhe formatin e madh. Nuk prisja të kishin punë aq të mira. Vërtet qenë të vjetra, të dëmtuara diku në ndonjë cep dhe letra u qe zverdhur nga koha, por kjo ua shtonte vlerën.

Ishin portrete grash të veshura me shumë finesë, sipas modës së shekullit të kaluar, punuar si vepra të vërteta arti. Disa kishin emra dhe vitin të shkruar me pendë dore në ngjyrë sepie ose tushi të zi, me një shkrim të pjerrët në kurbatura elegante. Për të tjerat, të pidentifikuar, kjo do të ishte puna që më takonte të bëja. Dhe do ta bëja këtë me lehtësi, pasi m'u duk se pothuaj të gjitha i njihja prej arkivit të fotografive që kisha në shtëpi.

I sigurova gratë se do të ishte kënaqësi për mua të merresha me atë punë. Ato më shihnin disi të zëna në faj, me siguri prej rërës së lagur apo llaçit të njomë që vazhdonin të ishin prezent në dhomë.


Mbaruam punë shpejt dhe ndërsa prisnim të vinte shoferi i shkurtër, i zoti i shtëpisë, ato menduan të vishnin Adaptin për rrugë.

U ngatërrova jo me dashje në atë punë të vështirë, vetëm ngaqë nuk m'u duk e sjellshme të rrija e t'i vështroja kur rrekeshin t'i vishnin një triko të madhe burrash prej leshi të gjelbërt të errët. Kur, më në fund, ia mbërthyen kopsat në atë trupin katërkëndësh, menduan t'i hidhnin sipër një pallto që të mund të arrinte gjatësinë e njëjtë me njerëzit e tjerë. Problem mbetej si do t'ia vishnin këpucët.

U dhashë mendimin se po të kishin një palë çorape pambuku të gjata, mund t'i fushnin ato lehtë në këpucë dhe ideja ime u pëlqye. Po si mund t'i lidhje ato çorape të futura në këpucë me trupin e tij të fryrë katërcepësh. Ndërsa përpiqeshim të gjenim zgjidhjen e duhur, vura re se ai vetë rrinte krejt i qetë dhe buzëqeshje i kapardisur në karrige, sikur të kënaqej me shqetësimin tonë. Nuk më pëlqeu fare kjo sjellje e tij.

Në këtë çast ia behu shoferi i shkurtër dhe i dha fund, duke e ngritur me lehtësi si pendë në krahë Adaptin, për ta ulur në sedijen e prapme që të ishte më i sigurt.

Që prej shpatullave të shoferit ai na vështronte me atë buzëqeshjen e tij të qetë, disi tallëse, dhe tundte këmbët prej çorapësh bosh, të futura në këpucë.



Ktheva kokën për t'i parë edhe një herë gratë. Të dyja kishin po atë shqetësim të momentit të parë: rëra ende nuk qe tharë. "Ato harrojnë erën e mirë të gëlqeres", - mendova, pastaj shtrëngova tubin nën sjetull, ku strukeshin fotografitë e çmuara, i përshëndeta dhe mora të dal jashtë. Shqita me kujdes këpucët prej pellgjeve ranore dhe u thashë me gjysmë zëri se s'ia vlente të shqetësoheshe për gjëra aq të parëndësishme.

Me shikimin e tyre të njëjtë mbi shpatullat e mia, eca derisa arrita te dera e oborrit.

Ato vazhdonin të qëndronin në këmbë, me të njëjtin mendim të pandryshuar, që e ndieja të shpërndahej në transparencën e ajrit të nderur midis tyre dhe meje.

NË TREN

Udhëtojmë në tren dhe kabina është shumë komforte. Ka hapësirë të bollshme dhe në një raft të posaçëm afër dritares kam vënë në punë printerin e vogël që shtyp. Mbi gjunjë kam një tufë letrash të shkruara e të pashkruara, me të cilat po merrem.

Bashkudhëtarja, një mesogrua e bëshme, rri ulur në të njëjtën anë me mua dhe ndjek me qetësi çfarë bëj. Megjithatë, diçka nuk është krejt ashtu siç duhet: nuk qëndrohet mirë në ato ndenjese komode.

- Ose stolat janë më të ngushtë seç duhet, - i drejtohem asaj, si për ta futur në bisedë të parëndësishme, - ose nuk mjafton vendi.

Ajo që thashë duhet të ketë pasur vërtet një kuptim të papranueshëm, se ajo ngrihet vrikthi, e kap shtypësin e gjorë, e përplas përtokë dhe e shtyp me këmbë.

- Mos, ç'bën, mos! - i thërras, por ajo më vështron me një xixëllimë në sy që të rrëgjon shpirtin dhe nuk të lë çap.

- E ke kot! - bërtet. - E ke fare kot! - dhe hap derën e kabinës e zhduket në natë duke lëshuar si breshëri automatiku përmbropa, një mori fjalësh trishtuese me frymë të verdhë.

Unë mbetem në mes të kabinës me letrat të hedhura përdhe dhe aparatin e shpartalluar që vazhdon regëtimën e punës së ndërprerë, me dridhma deri në fije të flokut.

Kalon një kohë tepër e gjatë, që më duhet të mbledh veten, të përpiqem të kuptoj çfarë ndodhi, një kohë vërtetësisht e pamatë. Më duhen vite që të përsëris me mend gjithë skenën, për të gjetur lidhjen midis shprehjes sime e britmës së saj në ikje.

Dhe besoj se dobësia ime e vjetër në matematikë nuk më ka lënë të përcaktoj përfundimin e këtij barazimi të thjeshtë me dy të panjohura.

LAKRA

Që ai burrë kishte një lakër në vend të kokës, kjo askujt nuk i bënte ndonjë përshtypje të madhe. Disave u vinte pak për të qeshur, për një pjesë tjetër kjo ishte ekstravagante, por njëkohësisht normale, ndërsa atij vetë nuk i vinte rëndë nga kjo.

Vetëm atë ditë kur ai e zjeu lakrën për ta ngrënë, u vu re mungesa e kokës së tij. Ai vetë nuk ishte në gjendje të shpjegonte pse e bëri këtë, prej urisë, prej mërzitjes apo nga pakujdesia, s'dinte ç'të thoshte. Por ndiente se kishte humbur diçka te vetja dhe kjo iu duk e dhimbshme. Mbi të gjitha, pikërisht në atë moment filloi të vuante prej dhimbjeve të kokës.

Për të tjerët rreth tij nuk dukej se po ndodhte ndonjë gjë e madhe, por për mirësjellje i vajtën për vizitë në shtëpi.

Atij iu bë qejfi, i prit mirë dhe hëngrën darkë bashkë. Mbas darke miqtë ikën disi të pakënaqur, ndoshta ngaqë iu duk se lakra që hëngrën nuk kishte qenë e zier aq sa duhej.

DRERË DHE FIZARMONIKË

poezi nga

Rigel Rizaj

QELQET

Fike dritën, të mbështillemi nën natë:
hëna është syri i një shtaze që ka qërruar tjetrin
dhe s'dua ta gjethojë mbi buzët e tua
atë bebëz prej argjendi,

trokitën, u thyen, u shkërmoqën mijëranjë copërash
qelqet thellë stomakut tim kur
e pëshpërita herës së fundit emrin tënd...

GJYSMA E MUSHKËRISË SIME

Gjysma e mushkërisë sime: një hemisferë me
akuj çehreçuditur!

Një bishë ndjek pas kalërimin e gjurmëve që
fashiten atypëraty.

Nën akuj, lulet nuhasin turinjtë e saj të kuq, të ligur,
ndërsa ajo shpejton si frymë e marrë dhe sa herë nuk
sheh send, pas i lë të bien si thërrime me qindra sy.

Gjysma e mushkërisë sime: një hemisferë me
akuj çehreçuditur!

Bisha me krifë argjendi, pas lodhjes, mbi shtrojet
e syve të vet do të flerë.

TI E SHPURE MELANKOLINË TEK JELET E KALIT

Ti e shpure melankolinë te jelet e kalit
dhe qafa e tij u zgjat,
– si e një mjellme, –
gjer në re...
(melankolia i brumosi një hënë
në kavitetin e gojës,
saqë kur teshtiu sakaq
e rrëzoi përdhë).

Ti e shpure melankolinë tek jelet e kalit:
barbaritë e ndjenjave mësynë rropullitë
e kafshës me sy të trishtë.

DRERË

Brinjët e tij ranë në borë kur qerpikëzinjtë puliti
tek e shihja larg, eshtrat m'i mbërtheu darë një dylqinjë,
prej algave të syve saj, një juntë drerësh doli e mbërriti
në lugthin tim, për drerin pabrirë morën miat brinjë.

FIZARMONIKË

Një borë e bardhë rigon dendur në fund të lugthit tim
majtas tij u lëngën brinjët e rrodhën teposhtë një
damari blu,

tashmë bosh, – si gojë shahriari hapur: se t'ikë
n'betejë ka përtim, –
me se do më zëvendësohet kjo kanistër brinjësh
munguar këtu?

Një fjollë bore ngre ortek e godet qytete në fund të
barkut tim
dhe shtazë dhe njerëz rendin çmendur me vetullat
plot frikë,

ca peshq rrinë pezull, brinjët e mbetura m'i këqyrin
me ngulmim
dhe njëri syresh kollitet, para syve më pështyn një
fizarmonikë.

GJUMI I GUGUFTUSË

Një dem i artë fle brenda mëlçisë sate të zezë
o gjel me lafshën e ngjyer thellë në perëndim,
ndërsa pula që ke mbarsur kakaris gjithë përtësë,
brenda vezëve saj bën mot me shi e bubullimë.

Një dem i artë sheh ëndrra brenda mëlçisë sate të zezë
pa ditur se ti viçat e tij brenda secilës vezë ke ngjizur,
po ajo guguftuja që fle mbi tjegulla me përtësë,
vallë po u zgjua, këtë skenë a ka për ta prishur?

PEIZAZH I BELIT DHE I PUTHJES

Beli yt: një serm që hëna e ka thithur si sfungjer
dhe hëna një tegel argjendi në musandrën e sates gojë;
seksi i zërit tënd mbi shaminë e trupit tim thur një
dantellë
dy buzët mia (jago dhe otello) n'tënden kërthizë nisin
një plojë.

E ARTË

e artë: flokët, gusha, lëkura dhe pushi i saj erotik,
më vjen të flëdem e si të jetë hoje ta përfund në fyt;

e artë: fryje veten në brinjët e mia si firzamonikë,
të kthehem, ta thyej drurin me cilin është bërë ky kryq.

SHTAMBË

merre këtë shtambë dhe ktheje në baltë
e bashkë me gjepuritjet bartur në grykë, hidhe në
bunar;
një shtambë brenda seksit të lules që ka çelur pranë:
aty tjerr në furkë, aty nepërken me gjilpërë fjalët në
gjerdef.

merre këtë baltë dhe piq me të një shtambë
shtamba brenda seksit i orgazmon pikësim, lules që ke
pranë.



Muzeu “Solomon” si tregues i humanizmit dhe altruizmit të qytetarëve të Beratit

nga Yzedin Hima

Dita e kujtesës (Shoah), 27 janari, është Dita e nderimit dhe kujtesës për miliona hebrenj, masakruar nga nazistët gjatë Luftës II Botërore. Bota në këtë ditë kujton barbarinë njerëzore në mes të shekullin XX. Qytetarët shkojnë në muzetë e ngritur dhe tronditen për mizorinë e dokumentuar, që njerëzit ushtruan ndaj njerëzve, nxitur nga urrejtja.

Në këta muzeume dallon qartë dështimin dhe rënien e qytetërimit të ndërtuar me mjaft sakrifica gjatë shekujve, pikërisht në shekullin modern. Tronditja është e madhe, sepse shihet se sa i brishtë është ekulibri dhe raporti midis humanizmit dhe urrejtjes, midis paqes dhe luftës. Në mes të shekullit XX qytetërimi rijetoi barbarinë e tij më ekstreme, rijetoi mugun e tij, teksa pa të bëheshin pluhur e hi, bashkë me librat e djegur në sheshet e Europës, institucionet e qytetërimit të ngritura me mund e mend gjatë shekujve.

Ka disa muzeume në botë që tregojnë për mizorinë e nazistëve ndaj qytetarëve hebrenj, ku vizitori, pavarësisht kombësisë së tij, ndihet i traumatizuar dhe e kap kompleksi i fajit, thjesht se ka qënë bashëkohës i mizorisë, bashkëkombas i mizorëve, apo sepse është thjesht njeri, sikurse lindën si të tillë edhe mizorët. Njenja të tjera përjeton vizitori kur vjen dhe viziton Muzeun “Solomon”, muzeun më të ri të qytetit muze, Beratit.

Pa dyshim, është i rëndësishëm një gur i latuar dikur nga banorët e këtij trualli, një vizatim në një shpellë, një fyell apo një lugë e gdhendur bukur në dru, një djep apo një tekst i vjetër kodiku, një tekst poetik i gdhendur në gur apo një kostum i vjetër zonjash, një ikonë e mesjetës, apo një shtëpi me arkitekturë karakteristike. Janë të rëndësishme për trashëgiminë tonë kulturore, por nuk duhet harruar se trashëgimia më e çmuar nuk gjendet në asnjë muze, por gjendet në çdo shtëpi të këtij qyteti dhe fshatrave të tij, gjendet te njeriu me një shpirt të lartë e të fisëm, me një shpirt të ndjeshëm nga burojnë sjellje dhe gjeste humane.

Është tashëgimia shpirtërore e banorëve të Beratit, që aq thesht dhe bukur është paraqitur në këtë muze nga themeluesi i saj poeti, studjuesi, publicisti, mësuesi Simon Vrusho. Berati ka disa muzeume të rëndësishëm si muzeu kombëtar “Onufri”, me pikturat mesjetare të një mjeshtri si Ai, vepra e të cilit me elementet e Rilindjes europiane e nderon Beratin duke e vënë në një radhë me qytetet ku u zhvillua kjo lëvizje artistike e kulturore, ka një muze etnografik me artefakte që tregojnë një qytetërim të hershëm e të pandërprerë, por i mungonte një muze si muzeu “Solomon”, i cili do të bënte të njohur në botë marrëdhëniet e qytetarëve të Beratit me hebrenjtë gjatë shekujve dhe posaçërisht, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Muzeu “Solomon” ka një jetë të shkurtër në qytetin

e Beratit, por gjatë këtij harku kohor prapun e tij e kanë kapërcyer mijëra vizitorë, që nga Parisi në New York, nga Moska në Rio De Zhanerio, nga Londra në Johannesburg, nga Madridi në Tokio etj. Ky muze, i konceptuar me thjeshtësi, por me shumë dashuri nga Simon Vrusho, i kuruar nga skulptori Nezir Ago, është bërë mjaft i njohur brenda dhe jashtë vendit.

Muzeu “Solomon”, i brishtë në pamje të parë, mbart një mesazh mjaft të rëndësishëm që qytetërimi ynë ia përcjell qytetërimit europian e më gjerë: humanizmin dhe altruizmin e një qyteti të vogël, në një kohë kur Europa dhe Bota kishte humbur çdo ekuilibër. Rrënjët e këtij humanizmi dhe altruizmi janë te njerëzit e thjeshtë të qytetit dhe fshatrave, banorët e të cilit qenë gati të vetësakrifikoheshin për të mbrojtur hebrenjtë e ardhur nga vise të ndryshme të Ballkanit për shkak të përndjekjes nga nazistët. Ky fakt e bën mjaft të besueshëm thënien se qyteti i Beratit është një qytetërim 2400 - vjeçar i pandërprerë. Vetëm në një qytetërim të tillë mund të kultivohej një ndjenjë kaq e fortë altruizmi.

Qytetarët e Beratit janë shquar gjatë historisë për humanizmin e tyre. Pavarësisht statusit shoqëror, besimit, ata kanë mirëpritur ardhësit. Studiuesi beratas Agim Mehqemeja shkruan se kanë qënë qytetarët e Beratit që u kanë bërë vend banorëve të Durrësit, pas shembjes së qytetit të tyre nga tërmetet e viteve 1372, 1905 dhe 1926. Banorët e Voskopojës, pas djegies së parë në vitin 1769 dhe pas tri djegieve të tjera si ajo e vitit 1916, u mirëpritën dhe u strehuan në qytetin e Beratit.

Duke qënë një qytet me kulturë të hershme, qytet ku punuan piktorë të shquar si Onufri e të tjerë, qytet i kodikëve dhe dijetarëve të shquar gjatë shekujve XVII-XVIII, qytet me një harmoni fetare të shenjuar, me ç’duket u parapëlqye edhe nga hebrenjtë gjatë shekujve, pikërisht për këto cilësi. Ata u bënë pjesë e ekonomisë dhe e kulturës së këtij qyteti. Pikërisht në këtë kohë, krahas poetëve të njohur si Nezim Berati, Sulejman Naibi, Mehmet Ashkiu, Fejziu, përmendet edhe poeti hebre Solomoni.

Thuhet se kur Mehmet Qypriju, zyrtar i lartë i Perandorisë Osmane me origjinë nga Berati, mori urdhër për të ndëshkuar udhëheqësin shpirtëror të hebrenjve Sabbatei Zevin, ai e dërgon atë në Berat tek miqtë e tij duke e lënë në besën e tyre.

Dita e Kujtesës në Shqipëri, posaçërisht në Berat merr edhe vlera të reja, krahas nderimit dhe kujtesës për qytetarët e martirizuar, në këtë ditë kujtohen dhe nderohen edhe ata qytetarë që strehuan dhe mbrojtën hebrenjtë nga nazizmi. Ne sot kujtojmë emër për emër qytetarët e Beratit që ndanë me hebrenjtë e ardhur strehën, bukën, kripën, ujin, duke

qënë të gatshëm të ndanin me ta edhe vdekjen.

Simon Vrusho ka biseduar me banorë të qytetit dhe fshatrave që strehuan hebrenjtë, ka sjellë emrat dhe kujtimet e tyre në librin “Hebrenjtë e Beratit”: “ Ne bëmë atë që duhet të bëjë njeriu për njerinë, - ka treguar Isuf Qojle,- të gjithë jemi bij të Zotit. Kam strehuar e ndihmuar Jakov David Asherin, me të shoqen Rashela e fëmijët.”

E kishim babanë mikëpritës,- kujton Shyqyri Civeja, të atin Qani Civeja. Babai thoshte shpesh: - Mikun dhe jabanxhinë e dërgon Zoti, ndaj duhen nderuar si mekam. Dhe erdhën tek ne Jozefi me të shoqen, fëmijët, dy djemë binjakë, vajza Sonja, Jakovi e Sarika me fëmijët, Isaku me të shoqen Pembe. Ne kishim tri shtëpi, dy ua lamë hebrenjve. Kur erdhën gjermanët ikëm shtëpiçe në Kamçisht te Muhamet Metko, dajua ynë. Me vete morëm të gjithë hebrenjtë.

Në familjen e Josif Dodit gjen edhe sot mobilje të punuara nga dora e Jusës, siç e thërritnin shkurt Jozef Adyzyssin, hebreun marangoz, strehuar nga beratasi Toli Dodi. Ka mjaft episode që janë sjellë si kujtesë qytetare në librin e Vrushos.

Sot në Ditën e Kujtesës ne kujtojmë 600 qytetarët hebrenj që u strehuan gjatë Luftës II Botërore në Berat: Në pamundësi për t’i përmendur të gjithë po përmendim emrat e disave prej tyre: David, Abraham, Solomon, Moisi, Jakov, Isak, Levi, Asher, Samuel, Joakim, Benjamin, Llazar, Mosha, Simeon, Gjoni, Pjetri, Aron, Mordo, Mushon, Jitzhak, Rashela, Sara, Sarina, Shabat, Bahar, Ruben, Kohen, Kalderoni, Jakoel, Pardo, Shvarc, etj. etj.

Natyrisht, në këtë Ditë të Kujtesës do përmendim edhe emrat e atyre qytetarëve beratas që mirëpritën dhe strehuan hebrenjtë: Isuf Qojle, Qani Civeja, Mehmet Xhezo, Halil Frashëri, Xhevat Gjergjani, Xhevahir Zaganjori, Vexhi Buhraja, Hysen Nallbani, Bari Zeko, Burhan Ruli, Sulo Muzhaka, Tajfur Haznedari, Asaf Xhufi, Gani Telegrafi, Sulo Droboniku, Tefik Ruzi, Taq Simsia, Lilo Xhimitiku, Jorgji Naço, Irakli Meroli, Gaq Kajana, Dhimitër Shyti, Llazar Sholla, Toli Dodi, Dhoksi Sfeci, Siku Gjogu, Kozma Gega, Llukan Gjika, Tasi Bixhonja, Vangjel Sota, Zoi Vesho, Grigor e Peçi Shkurti, Jorgji Angjeliu, Resmeie Spathara, Ndon Papai, Miti Cania, Vlash Myzeqari, Hiqmet Çipi, Bajram Ago, Qerim Kasapi, familja Vruho në Mangalem etj etj.

Muzeu “Solomon”, i ideuar dhe ngritur me pensionin e tij të varfër nga Simon Vrusho, përcjell diçka tjetër nga ajo që përcjellin muzetë në New York, Washington, Londër, Paris, Tel Aviv, e gjetkë. Tek ky muze vizitori s’takon dhunën, por përkujdesjen, s’takon urrejtjen, por dashurinë, s’takon sadizmin, por harmoninë e gjinisë njerëzore, pavarësisht nga kombësia dhe gjuha, pavarësisht nga besimi dhe feja, pavarësisht nga kultura dhe pasuria.

Ky muze është mjaft i thjeshtë në dukje, por ai përcjell një mesazh të mrekullueshëm. Këtu njeriu ndihet i denjë përballë historisë, krenar që është njeri, sepse disa banorë të këtij qyteti, të cilët nuk njihnin historinë e madhërisme të hebrenjve, që nuk kishin dijeni për gjenitë e këtij populli, që nuk dinin për udhëtimin e tij biblik, në kohë e hapësirë drejt dritës, u dolën para dhe i pritën.

Vizitorët e kujdesshëm të qytetit të Beratit habiten me arkitekturën e lagjeve muzeale të qytetit, por tronditen me “arkitekturën” shpirtërore të qytetarëve të tij, kur vizitojnë muzeun “Solomon”.

Në këtë Ditë të Kujtesës, teksa kthejmë kokën pas nënvizojmë: “Dy gjera të shenjta ka ruajtur qyteti i Beratit në shekullin XX, kodikët dhe hebrenjtë”, ndaj lipset ta mbajmë të gjelbër Pemën e Kujtesës!



MARRËDHËNIE MITIKE SHKRIMTAR- LEXUES

Çmitizimi i shkrimtarit

nga Mira Meksi

Në fillim të kohërave shkrimtari nuk ishte, vepra e shkruar, ekzistonte lexuesi që e lexonte, porse shkrimtari nuk qe, ose më mirë, nuk qe i dukshëm, qe i padukshëm dhe, për pasojë, nuk kishte as marrëdhënie të drejtpërdrejta shkrimtar-lexues. Ç'do të thotë kjo? Do të thotë se vetëm në Greqinë e shekujve IV-VI para erës sonë doli në dritë autori, shkrimtari. Deri përpara kësaj periudhe *autorësia* e shkrimtarit shihej si gjëja më e papeshë e një veprë. Si provë e kësaj mund të sillen pa mëdyshje dy kryeveprat me të cilat nis letërsia e madhe: “*Iliada*” dhe “*Odiseja*”. Njohja e *autorësisë* së tyre Homerit është e mëvonshme, zë vend pikërisht gjatë periudhës së përmendur, ndërkohë që para saj flitej për “homeridët”, për një mori *aedësh*, të pranishëm në *textus* me të tëra tiparet e tyre vetjake. Porse duke nisur nga shekujt VI-V para erës sonë autorësia sa vjen e bëhet gjithnjë e më e pranishme, madje edhe *përcaktuese* për veprën letrare. Dukuria e *autorësisë*, e *identifikimit* dhe e *njohjes* së shkrimtarit zë fill gjatë viteve kur letërsia futet në rivalitet me retorikën dhe eristikën (me ligjërimin bindës të sofistëve), ku rivaliteti lidhej me përfitim e një pozite dominuese në shoqëri. Në këto kohë rektorët, sofistët dhe poetët filluan të identifikohen si *klasa të veçanta shoqërore*, ku secila rrihte që të shfaqej në rolin e udhëheqësve, duke u përpjekur gjithkush, sipas mjeteve dhe formave të lëvruara, që të manipulonte një bashkësi, gjithherë e njëjtë dhe e vetme: audiençën, “klasën” e popullit. Jemi në lindjen e figurave mitologjike të epokës së racionalizmit, në vend të hyjnive antropomorfe kemi njerëz teomorfë, jemi në kohën kur lind miti i shkrimtarit, i rektorit, e sofistit. Një gjerdan pamëshish të kësaj dukurie të re në shoqërinë helene e hasim nëpër jo pak dialogë të Platonit, madje në trajtat e një kritike të ashpër. Sa për shkrimtarin, një kahje e këtillë sa vjen e i kthehet në mani, përpjekjet e tij sa vijnë e përqendrohen në arritjen e një pozite të qëndrueshme dhe me ndikim ndër masa e në shoqëri. Ndryshe nga rektori dhe sofisti, të cilët mbeten në kuadrin e manipulimit të opinionëve dhe bindjeve të masës, shkrimtari rreket të depërtojë dhe të punojë në kuadrin e psikës së njeriut; kjo është edhe një nga arsyet pse kryeveprat e tragjedisë e të komedisë së lashtë greke lëvizin dendurazi në botën e psikës, duke u rrekur që të krijojnë *shock-un*, trandjen emocionale, madje, sipas Platonit, duke zgjuar “ato pjesë të shpirtit që i rrëshqasin më së shumti kontrollit të arsyes”. Pra, shkrimtari në këtë kohë arrin të ketë në dorë (të manipulojë) ndjenjat dhe psikën e lexuesit, ai është Zoti, miti, magjistari për lexuesin; marrëdhënia shkrimtar-lexues është krejt e njëanshme. Një shembull të qartë të kësaj kahjeje që shoqëron dukurinë e *mitizimit të shkrimtarit* (deri edhe të shfaqjes së tij si magjistari) e gjejmë te një nga mitet më të famshme që kemi nga mitologjia greke. Fjala është për mitin e Akoncios dhe Sidipës. Ky mit na rrëfen se si Akoncioja, një djalosh mjaft i pashëm dhe prej dere të kamur nga Kiosi, shkon një ditë në Delos për të bërë një blatë në nder të Artemidës. Atje i qëllon të shohë Sidipën, një hyri athinase, që gjendej në Delos për të bërë një

blatë në nder të Apolonit. Djaloshi e ndjek pas duke u përpjekur që të mos i binte në sy. Ato çaste, me sytë që i shkreptinin nga përvëlimi i epsheve mërshore, i vetmi mendim që i shtizonte keqas trurin ishte gjetja e një mënyre për *ta shtë në patjetër në dorë* Sidipën e bukur dhe, për të qenë i sigurt në përpjekjet e tij, hedh një mollë në kopshtin ku kjo shëtiste e lumtur, mbi lëkurën e së cilës pati *shkruar*: “Të betohem për Artemidën, o Akoncio, se s’do të jem e tjetërkujt, por vetëm jotja” dhe fshihet pas një gëmushe. Mëndesha e Sidipës e sheh mollën poshtë këmbëve ndërsa po shëtitnin dhe, ndonëse *nuk dinte të lexonte*, tërhiqet nga shenjat që dukeshin mbi lëkurën e frytit, arsye për të cilën e merr dhe ia jep vashës, që *dinte të lexonte*. Kjo e lexon çfarë ishte *shkruar*, bën pa dashje një betim në emër të Artemidës dhe, pa e vrarë fort mendjen, e hedh frytin tej për të vijuar sakaq shëtitjen e saj. Shumë herë familja vendosi që ta martonte, porse pak përpara se të bëhej dasma vasha mbërthehej nga ethe të forta: hyjnesha po kërkonte të mbahej premtimi i dhënë përmes betimit në emër të saj, ndonëse ky premtim ishte dhënë në mënyrë të pavetëdijshme e pa dashje. Nga ana tjetër, enigma e rënies ligsht e Sidipës një natë përpara dasmës nuk mund të ndriçohej e zbërthehej përveçse nga Akoncioja, i cili *shkruan* sërish, duke ndriçuar kumtin dhe shkakun e ngjarjeve. Prindërit e Sidipës, që s’dinin të lexonin, ia japin pusullën e mbërritur, prej nga vasha mëson të vërtetën, porse nis t’i qëndrojnë e paepur dëshirës së Akoncios. Ky i *shkruan* sërish, porse Sidipa s’pranonte t’i lexonte pusullat e tij. Po sikur të ishte një truk tjetër? Po sikur të ishte një kurth akoma edhe më mizor? Po sikur ajo çka ishte shkruar të ishte një magji, që do ta shtrëngonte t’i jepej pa dëshirë djaloshit? Pyetje të tilla i trazonin tërë qenien sa herë në shtëpinë e saj mbërrinte një



pusullë nga Akoncioja. E kjo histori vazhdoi gjatë, me Sidipën që binte në lëngatë një natë përpara martesës me mëtonjësin e radhës, derisa në fund, në një prej këtyre netve lëngatash i mbërrin sërish një pusullë nga Akoncioja, që i sillte ndër mend premtimin e dhënë përmes betimit në emër të Artemidës; ishte e dyta dhe e fundit letër që Sidipa lexoi, pasi mëngjesin e ditës tjetër të tilla net lëngatash marrin fund: familjarët e gjejnë në dhomën e saj truppajetë.

Miti i Akoncios dhe i Sidipës na rrëfen në mënyrë simptomatike një gjerdan tiparësh dhe ngjyresash të spikatura që kanë karakterizuar *shkrimtarin* dhe *marrëdhëniet* e tij me *lexuesin*. Akoncioja, si njeri që *shkruan*, mund të shihet si një figurë e shkrimtarit; madje fjala është për një njeri që jo vetëm *shkruan*, por dhe arrin ta shfrytëzojë *shkrimësinë* si instrument, si një armë të fuqishme, madje jepet si e vetmja armë që i ofronte *sigurinë* për arritjen e qëllimit: të *shtë në dorë* Sidipën, *objektin* e dëshirës, ta bënte të vetën dhe për vete, duke mos i lënë kësaj asnjë *liri* në zgjedhje. Sidipa mund të shihet si një figurë e lexuesit, për aq sa është e vetmja që di të lexojë në familje, e *manipuluar* e deri e *magjepsur* prej shkrimtarit. Po sot, në botën moderne, përherë e më pak naive, përherë e më tepër të çprangosur nga mitet, cila është marrëdhënia shkrimtar-lexues? Përgjigjen e jep një i llojit, shkrimtari i njohur Javier Marias, i cili e nis dritëdhedhjen mbi këtë marrëdhënie me pyetjen: “Si është e mundur që njeriu i sotëm modern i beson shkrimtarit, asaj që vetë shkrimtari e shpall që në krye të herës se është rremtësi, pra diçka që s’ka ndodhur vërtet dhe që, ndonëse rrëfëhet në vetë të parë a të tretë ngjarja, dihet mirë se është autori që flet, madje, si për t’u bërë i tërëpranishëm, ai ka vendosur edhe foton e tij në kopertinën e librit?...” Paskëtaj ai vetëpërgjigjet: “Në thelb, ne të gjithë priremi ta shohim veten në etapat e ndryshme të jetës sonë si rezultati i asaj që na ka ndodhur dhe asaj që kemi arritur apo kemi realizuar, sikur vetëm kjo të konfirmonte ekzistencën tonë. Dhe pothuaj përherë harrojmë se jeta e njerëzve nuk është vetëm kjo: çdo trajektore përbëhet edhe nga humbjet tona, nga mosarritjet dhe dëshirat e papërmbushura, nga ajo që ndonjëherë e lëmë mënjanë apo nuk e zgjedhim, apo nuk e arrijmë, nga mundësitë e panumërta që në më të shumtën e rasteve nuk arriten të realizohen - të gjitha përveç njëjës, në fund si ëmbëlsirë - nga mëdyshjet dhe ëndërrimet tona, nga projektet e dështuara dhe nga dëshirat e rreme apo të vakëta, nga frikërat që na paralizuan, nga ajo që e braktisëm apo që na braktisi. Në fund të fundit, ne ndoshta pranojmë se ekzistojmë po aq në atë që jemi sa në atë që nuk kemi qenë; njëlloj si në atë që është e vërtetueshme, e matshme, e kujtueshme, edhe në atë që është më e pasigurt, më e pavendosur dhe e megjullt, ndoshta jemi bërë në të njëjtën masë nga ajo që ishte dhe nga ajo që mund të ishte. Dhe guxoj të mendoj se është pikërisht rremtësia (fiksioni) që na e rrëfen këtë, a më mirë të them ajo që na shërben për të kujtuar këtë dimension, të cilin zakonisht e lëmë mënjanë në çastin kur bëjmë bilancin dhe shpjegojmë vetveten apo jetën tonë.”

Në këtë botën e sotme, pra, shkrimtari nuk është më “magjistari” i dikurshëm dhe marrëdhënia e tij me lexuesin nuk ka më ngjyresa mitike. Shkrimtari i sotëm është çmitizuar; marrëdhënia shkrimtar-lexues është komplementare, shkrimtari mbush zonat e errëta të jetës së lexuesit, i cili ka nevojë për rremtësi (për produktin e shkrimtarit) që të plotësojë bilancin e jetës së tij, ndërkohë që vepra vetë realizohet nëpërmjet leximit (nëpërmjet lexuesit) “... ndoshta nuk është e drejtë ajo që thashë në fillim se vepra letrare nuk rrëfen atë që ka ndodhur, - vijon Javier Marias-i. - Ndoshta në të vërtetë veprat letrare *ndodhin* nga fakti që ekzistojnë dhe lexohen dhe, po ta shohësh me kujdes, pas kaq shumë kohësh është më real dhe i vërtetë romani *Don Kishoti* se tërë bashkëkohësit e tij historikë të Spanjës së shek XVIII.”

ISAAC BASHEVIS SINGER

Kush ka nevojë për letërsinë?

Herë pas here pyes veten: kush ka nevojë për letërsinë artistike? Pse të trillosh kur natyra dhe jeta krijojnë kaq shumë ngjarje të çuditshme? Sepse, pavarësisht nga fuqia e imagjinatës, ne s’jemi në gjendje kurrësi të konkurojmë me befasishtë e fakteve dhe gjendjeve psikologjike të realitetit. As pena e mjeshtrit më të madh s’mund të jetë aq e logjikshme dhe e saktë në përshkrimin e një histori faktesh të dëshmuara me dokumente apo mbi të cilën hidhet dritë gjatë një procesi gjyqësor në gjykatë. Ashtu siç dihet se s’ekziston vrasja e përsosur, po ashtu s’mund të ketë një roman të përsosur. Madje edhe “Ana Karenina”, dhe “Zonja Bovari” i kanë të metat e tyre, mungesa të njohura vijimësie që i gjen në çdo krijim letrar. Unë vete kam arritur në pikën që një kronikë gazete ose një “rast historie” më intereson më shumë se një vepër letrare. Pse u dashkan të gjitha ato shpjegime psikologjike kur nuk sqarojnë asgjë për emocionet? Pse ta vrasësh mendjen të vërtetosh një gënjeshtër kur e vërteta duket sheshit?

Unë kam frikë jo rrallë se i gjithë njerëzimi herët a vonë do të arrij në përfundimin tim: leximi i krijimit letrar është harxhim kohe.


Po pse duhet të kem frikë? Thjesht se unë vetë mund të jem një nga viktimat?

Jo, nuk është thjesht kjo. Edhe pse sot mund të ngjitemi në Everest me helikopter, do të ishte për të ardhur keq nëse do të reshtnim së provuari t’i ngjiteshim në këmbë deri në majë. Vlera e letërsisë artistike nuk qëndron vetëm në aftësinë për t’i argëtuar dhe për t’u mësuar diçka lexuesve, por edhe tek të qenët si sport, një sfidë intelektuale. Edhe nëse do të shpikej një makinë që na raporton saktësisht të gjitha përvojat e një Raskolnikovi, një zonje Bovari, apo të një Ana Karenine, sërish do të ishte interesante të denim nëse kjo mund të bëhej duke e shkruar me letër dhe stilolaps.

Kjo qasje ndaj letërsisë nuk është ende e rëndësishme për shkak të faktit të thjeshtë se një makinë e tillë nuk ekziston. Por gjithfarë forcash të lloj llojshme po i mbledhin ngadalë dhe po i bashkojnë pjesët e kësaj makine. Lexuesit modern dinë gjithnjë e më shumë rreth psikologjisë, dhe për ta shpjegimet e shkrimtarit shpesh duken të panevojshme, të pavërteta, dhe të dala mode. Ata lexojnë shumë, ndaj asnjë temë nuk i trondit sa duhet për t’i befasuara. I marrin faktet nga gazetat,

revistat, radio, televizioni ose filmat. Lidhen me të gjitha cepat e botës dhe asgjë e shpikur nga mendja s’mund të krahasohet me atë që ndodh në realitet. Ende ka një mundësi që në ditët tona – ose tuajat — njerëzimi të arrij në hënë, ose në një nga planetet. Të gjitha fantazitë e të ashtuquajturës “fantashkencë” do të zbehen nga pamjet e marra nga hëna ose planetet e tjerë.

E thënë troç, letërsia duket se do të mbijetonte si sport intelektual. Po të ishte sport për të do të interesoheshin ata që luajnë por edhe amatorët.



Dikush që shkon në këmbë në Kaliforni mund të nga ngjall admirim, por e ecura në këmbë që bën ai nuk do të merrej parasysh si mjet komunikimi. Për këtë arsye, kam frikë nga dita kur letërsia artistike do të kthehet në sport. Mua më duket shpesh se kemi arritur në këtë pikë. Në të vërtetë tashmë kjo ka ndodhur me poezinë, përfshirë poezinë në gjuhën tonë jidisht. Fjala poetike tani lexohet vetëm prej poetëve. Në një tokë kaq të madhe dhe të pasur si Shtetet e Bashkuara, veprat

poetike shpesh botohen në 500 kopje dhe një pjesë e tyre shpërndahet nga autorët mes miqsh. Drama s’e ka arritur ende gjendjen e trishtuar të poezisë, por po shkon në të njëjtin drejtim.

Për sa i përket prozës letrare, të krijohet ndjesia se gjërat po shkojnë mirë. Librat në prozë ende blihen me qindra, mijëra kopje. Por po ta shohësh pak më thellë çështjen, vërejmë se ajo çfarë sot e quajmë “letërsi artistike” shpesh është shumë larg letërsisë artistike. Veprat e botuara shpesh shiten të përcatuara si “romane” ndërkohë që janë një e katërta ose njëqind për qind gazetari.


Në asnjë kohë tjetër, kufiri mes gazetarisë dhe letërsisë nuk ka qenë kaq i hollë dhe i paqartë se sa në kohën tonë. Mua më duket shpesh se kritikët vuajnë nga amnezia. Ata kanë harruar rregullat fillestare të lojës së quajtur letërsi. Nuk është ndonjë fitore e madhe në një lojë shahu nëse, nëse që nga fillimi, një lojtar ka më shumë gurë shahu se tjetri, ose nëse rregullat e lojës ndryshojnë pas çdo loje.

Çdo amnezi ka qëllimin e saj të fshehur, dhe amnezia letrare e kohës tonë nuk është thjesht një lloj sëmundje e rastësishme. Ajo ka prirjet dhe objektivat e saj. Botuesit e mëdhenj, makinat e panumërta të shtypshkronjës, masa e lexuesve e krijuar falë zhdukjes së analfabetizmit, këtyre s’u mjafton më numri i vogël i talenteve të vërtetë të

lindur në një brez të vetëm. Përveç kësaj, talentet e vërteta s’e kanë më fuqinë ose mjetet për të ndikuar tek lexuesit siç ndodhte një apo dy breza më parë. Në vend që të pranojnë se ka krizë në letërsi dhe se gazetaria duhet të ndërhyjë në emër të letërsisë, kritikëve letrarë dhe botuesve, dhe shpesh në emër të vetë shkrimtarëve të cilët me vetëdije por më shumë pa vetëdije, e kanë ndryshuar konceptin e letërsisë, në pamje të pare duke e zgjeruar tej mase, por në të vërtetë duke e ngatërruar dhe harruar. Është njësoj sikur njerëzit që luajnë një lloj sporti papritur të vendosin që një pjesëmarrës garës në vrap mund të garoj hipur në biçikletë. Ky lloj revolucioni në vend që ta pasuroj garën, e varfëron dhe e zhduk atë.

Pikërisht në kohën e specializimit të madh, në kohën kur çdo shkencë është e ndarë në degë të ndryshme për arsyen e thjeshtë se secila kërkon vëmendjen e plotë të një shkencëtari – letërsia ka përjetuar një shkrirje të të gjitha forcave të saj. Si pasojë kemi një përzierje dhe çorbë të metodave dhe mënyrave të komunikimit që kanë veç një vlerë: mashtrimin. Ne nuk e kemi zgjeruar konceptin e prozës artistike, thjesht e kemi zgjatuar dhe gjymtuar. Një vepër moderne e letërsisë artistike shpesh përmban ese amatore për psikologjinë dhe psikoanalizën, shumë informacione gazetareske që mund t’i gjejmë fare lehtë

në gazeta, revista ose enciklopedi, gjithfarë teorish popullore dhe faktesh kinse shkencore, madje shpesh edhe artikuj kritikë, shaka dhe batuta të satiristëve letrar, mendime politike, mesazhe, fakte nga seksologjia dhe kështu me radhë. As shkrimtarët dhe as kritikët tani s’kanë asnjë ide se çfarë është dhe çfarë nuk është letërsi, çfarë është krijuar dhe çfarë është huazuar, kur shkrimtarët ecin me këmbët e veta apo kur hipin në qerren e



dikujt tjetër. Çfarë ndryshimi ka nëse një vrapues garon në këmbë apo hipur në biçikletë? E vetmja gjë e rëndësishme është të arrish në fund më shpejt se të tjerët. Kritiku modern ka vetëm një njësi matëse: efektin, provokimin që vepra letrare ngjall tek lexuesit që nuk janë shijehollë, dhe efektin që mund të ketë e njëjta vepër kur përshtatet si shfaqje televizive ose film.

Mundohuni të përfytyroni një shkrimtar i cili shkruan për të njëjtën temë si Floberi, dhe krijon një lloj “Zonja Bovari” të re, por me Luftën e Dytë Botërore si sfond të ngjarjeve. Romani, përveç historisë së një femre jo besnike, do të japë historinë e ngritjes së nazizmit hitlerian, spastrimet e Stalinit, shfarosjen e gjashtë milion hebrenjve, historinë e lëshimit të bombave atomike në Hiroshima dhe Nagasaki, rrëzimin nga fronti të mbretit Eduard për hir të zonjës Wallis Simpson, revolucionin në Kinë dhe kush e di çfarë tjetër. S’ka nevojë t’ju them se është fare e lehtë që dikush ta shkruaj një roman të tillë. Një zonjë Bovari moderne s’ka pse të rebelohet në një qytezë. Ajo mund të udhëtoj me aeroplan. Madje përveç kësaj, mund të jetë spiune sovjetike, agjente e dyfishtë ose e trefishtë. Një shkrimtar i aftë mund t’i krijoj të gjitha këto, dhe të gjitha faktet t’i lidh me njëra-tjetrën në një mënyrë që ka kuptim. S’është nevoja të thuhet se një vepër e tillë do t’i ngacmonte lexuesit shumë më tepër se sa historitë për një grua provinciale që tradhtonte të shoqin. Është e vërtetë, Lufta e Dytë Botërore me të gjitha tmerret dhe barbaritë e tjera është portretizuar tashmë nga të tjerët, dhe shkrimtari s’ka çfarë t’i shtojë asgjë kësaj. Por as lexuesi dhe as kritiku bashkëkohor nuk janë të interesuar për rregullat e lojës, kur përcaktojnë letërsinë artistike. Recensuesit për këto lloje librash shpesh shkruajnë: “Qëndrova gjatë gjithë natës duke e lexuar sepse nuk e lëshoja dot nga dora”, “Rrënjës”, “S’do ta harroj kurrë”, dhe gjëra të tilla. S’e teproj kur them se numri i këtyre veprave vetëm shtohet. Vepra të

tilla marrin çmime. Shkrimtarë të tillë shpallen si gjeni të letrave.

Për ata që interesohen vërtet për letërsinë dhe arritjet e saj, vepra të tilla janë shenjë e një rënieje tragjike, një sëmundje që njerëzit përpiqen ta mbulojnë me lëvdata, mjekime të rreme, injeksione të dëmshme dhe droga. I kemi zgjeruar aq shumë përkufizimet dhe i kemi shformuar aq shumë rregullat sa gjithkush mund mund të luaj dhe gjithkush mund të fitoj. Kushdo që e kupton se sa rrallë lind një talent i vërtetë dhe sa jashtëzakonisht e vështirë është të jesh origjinal, të zbulosh diçka tënden në artin e shkrimit, mund ta shoh fare qartë se s’kemi të bëjmë me përparim por me prapavajtje, një lloj anarkie letrare e cila është e dobishme vetëm për botuesit e mëdhenj dhe shtypshkronjat e tyre, për televizionin dhe Hollivudin.

Si rregull, parazitët rriten dhe zhvillohen në një organizëm të sëmurë. Në vend që të fajësojmë parazitin, duhet të kontrollojmë pse organizmi i sëmurë ka humbur imunitetin.

Pse është në këtë gjendje poezia? Çfarë po ndodh me dramën? Dhe si ka mundësi që prozës letrare i duhet të shkoj përtej kufijve të saj të natyrshëm dhe të shndërrohet në një çorbë stilesh dhe faktesh në mënyrë që të bëhet tërheqëse për lexuesin?

Arsyeja është se thelbi i letërsisë, portretizimi i karaktereve, shprehja e individualiteteve, nuk ka pasur kurrë shumë lexues të panumërt. Edhe në kohërat më të mira, lexuesit e letërsisë nuk kërkonin për të gjetur kryesoren tek vepra letrare, por elementet me rëndësi dytësore. Ata që nuk i vizitojnë muzetë për të parë pikturat por sepse mendojnë se duhet, ose ngaqë duan të takojnë dikë atje, janë gjithmonë shumica. Në një kohë tjetër, kur nuk kishte gazeta të mëdha, nuk kishte revista kombëtare, kur edhe librat e historisë gjendeshin rrallë dhe shkruheshin keq, lexuesit e letërsisë gjenin tek veprat letrare më shumë se sa synonte autori, pasi merrnin informacion nga të gjitha llojet e fushave të dijes. “Lufta dhe paqja”,

për shembull, për këta lloj lexuesish ishte vepër historike për Luftërat e Napoeonit, përshkrim i ushtarëve dhe aristokratëve rusë, libër udhëtimi. Lexuesit shpesh nga romanet mësonin rregullat e mirësjelljes, si dashuronin njerëzit, si e kalonin kohën, si visheshin, dhe kështu me radhë. Veprat e letërsisë artistike ishin dikur mjeti i vetëm me të cilin lexuesit mund të hasnin psikologjinë dhe, në shumë raste, psikoanalizën. Jo pak lexues i përdornin tekstet letrare thjesht për të mësuar sintaksën dhe gramatikën. Dhe të gjitha këto ishin edhe më të vërteta për spektatorët e teatrit.

Kjo epokë e re, në një farë kuptimi, solli një ndryshim rrënjësor. Lexuesit marrin informacion të pafund nga radio, filmi, shtyp dhe televizioni. Ata dëgjojnë leksione për psikologjinë dhe psikoanalizën. Shohin emisione për udhëtime, shpesh udhëtojnë edhe vetë, dhe kanë njohuri për botën. Nëse letërsia artistike dhe teatri do të vazhdonin të luanin rolin e dikurshëm, ato do të kishin nevojë për një audiencë që ka interes të madh për karakterin dhe individualitetin njerëzor, të pavarur nga të gjitha këto gjëra anësore dhe shqetësime jashtëletrare. Por numri i këtyre njohësve të shkëlqyer të artit është i vogël. Njohësit e shkëlqyer dhe të vërtetë të artit janë pothuajse po aq të rrallë sa artistët e vërtetë dhe të pastër.

Pikërisht, për arsye se njerëzit sot janë të rrethuar nga një det informacioni që lidhet me të gjitha llojet e fushave të dijes, artistët e mirëfilltë modern duhet të na japin gjithnjë e më shumë pastërti artistike, më shumë thelb, të përqendrohen më shumë në portretizimin e karaktereve dhe individualiteteve. Por që ta bësh këtë duhet të kesh dhunti të jashtëzakonshme. Me pak fjalë, të jesh origjinal dhe krijues në mënyra të reja sot është më e vështirë se kurrë.

Marrë nga “Los Angeles Review of Books” 2019, i përkthyer në anglisht nga David Stromberg. Teksti origjinal në jidisht u botua në 1963.

Përktheu: Granit Zela

Siddhartha

Hermann Hesse



Onufri